

الله
رسول
محمد

ISLAMI FEJA E LEHTËSISË

"... Allahu me këtë dëshiron lehtësim
për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."
(Bekare, 185)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

Feja Islame është feja më e mirë dhe më e përshtatshme për të gjithë njerëzit. Andaj Allahu Ëslamin e ka pëlqyer dhe e ka zgjedhë si fe të lehtë për mbar njerëzimin. Kështu që njerëzit nuk e kanë aspak të vështirë që ti përshtaten dhe ti nënshtrohen dispozitave, rregullave dhe obligimeve të kësaj feje hynore. Kjo fe hynore njerëzit i largon nga të gjitha vështirësitë, lodhjet, brengat, pikëllimet, shqetësimet, mërzitjet, mundimet, torturat, hallet dhe dertet. Në të njëjtën kohë kjo fe, njeriun e njofton dhe se duhet ti drejtohet vetëm Atij që e ka krijuar çdo të mirë në dobi të besimtarëve të devotshëm.

Pejgamberi a.s muslimanët që i ka pasur afër, gjithmonë i ka urdhëruar ta “lehtësojnë” fenë Ëslame e jo ta vështirësojnë. Atëherë ajo që u përketë besimtarëve të sinqertë është bindjen e këtij urdhërit, dhe mos tua tregojn njerëzve të vështirë atë që është e lehtë. Në lidhje me këtë temë një thënjë e Pejgamberit a.s është kështu:

“Lehtësoni, mos vështirësoni, përgëzoni, mos urreni, kaloni mirë me njëri tjetrin dhe mos bini në mosmarrëveshje”.

Prandaj ky libër është shkruar me qëllimin që njerëve t’ua përkujtoj edhe këtë thënjë të Pejgamberit a.s dhe lehtësinë e zbatimit të fesë Ëslame.



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



ISLAMI FEJA E LEHTËSISË

"... Allahu me këtë dëshiron lehtësim
për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."
(Bekare, 185)



HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)




Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze,



Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Për lexuesin

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

PËRMBAJTJA

HYRJE	9
KUR'ANI, ËSHTË NJË UDHËZUES QË TË DËRGON KAH E LEHTA	12
ALLAHU E KA URDHËRUAR ATE QË ËSHTË E LEHTË	18
SPROVA QË KA KRIJUAR ALLAHU ËSHTË SHUM E LEHTË	31
LEHTËSIA E JETESËS SË MORALIT TË KUR'ANIT	51
DINAKRIA E DOBËT E SHEJTANIT	74
PËRFUNDIM	78
MASHTRIMI I EVOLUCIONIT	82

Ajetet që janë përdorën në këtë libër janë marruar nga KUR'ANI-i më përkthim dhe komentim në gjuhën shqipe, i përgaditëuar nga H. Sherif Ahmeti.

www.harunyahya.com/albanian

www.harunyahya.com

www.en.harunyahya.tv

HYRJE

F eja Islame është feja më e mirë dhe më e përshtatshme për të gjithë njerëzit. Andaj Allahu Ëslamin e ka pëlqyer dhe e ka zgjedhë si fe të lehtë për mbar njerëzimin. Kështu që njerëzit nuk e kanë aspak të vështirë që ti përshtaten dhe ti nënshtrohen dispozitave, rregullave dhe obligimeve të kësaj feje hyjnore. Kjo fe hyjnore njerëzit i largon nga të gjitha vështirësitë, lodhjet, brengat, pikëllimet, shqetësimet, mërzitjet, mundimet, torturat, hallet dhe dertet. Në të njëjtën kohë kjo fe, njeriun e njofton edhe se duhet ti drejtohet vetëm Atij që e ka krijuar çdo të mirë në dobi të besimtarëve të devotshëm. Dhe si rrjedhojë e kësaj ata duhet vetëm Atij ti besojnë, vetëm Atë duhet ta falënderojnë, vetëm Atij duhet ti mbështeten dhe duhet të kërkojnë vetëm nga bujaria, mirësia, mëshira dhe falshmëria e Tij e madhe.

Ai njeri i cili e benë mik Allahun, i mbështetet dhe i beson Atij, gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë do të jetoj një jetë të lumtur, pa pikëllime, pa shqetësime, pa brenga, pa mërzitje dhe pa vështirësi. Prandaj kjo është njëra nga bukurit dhe lehtësitë më të rëndësishme që sjellë feja Islame për atë njeri që e jeton moralin e Kur'anit. Kështu që edhe Allahu në shumë ajete Kur'anore ka njoftuar se të gjitha obligimet dhe ligjet e Tij janë të përshtatshme me natyrshmërinë e njeriut dhe se brenda këtyre nuk gjendet ndonjë vështirësi e madhe.

Allahu në Kur'an ka njoftuar se morali i Kur'anit është i lehtë për tu jetuar dhe se do t'ua lehtësoj punët atyre që do të jenë pjesëtar dhe anëtarë të fesë hyjnore, Islamit.

“Dhe Ne do të drejtojmë ty në më të lehtën” (A'laë, 8)

“... Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit...” (Haxh, 78).

Edhe Pejgamberi a.s në drejtim të këtyre ajeteve Kur'anore duke thënë: *“Feja është e lehtë”* i ka thirru njerëzit që të jenë pjesëtar dhe anëtarë të kësaj feje, po edhe në të njëjtën kohë i ka thirrur edhe tu nënshtrohen dispozitave, obligimeve dhe ligjeve të sajë.

Besimi ose zbatimi i obligimeve që njerëzit i shohin si të vështira në fe, janë citur dhe përcjellë pas ardhjes së fesë, nga ana e mushrikëve ose nga ana e jobesimtarëve që kanë dashur t'i largojnë njerëzit nga feja Islame dhe kështu, ua kanë përcjell njerëzve sikur janë pjesë të fesë së vërtetë. Në këtë mënyrë ata, gjithmonë janë munduar që Islamit ta tregojnë si të vështirë në zbatim dhe përveç kësaj, edhe disa persona për veten e tyre e kanë përvetësuar një fe sa për sy e faqe, duke u mbërthyer në mashtrimin e asaj se do të jetë me e pranueshme dhe më e dobishme për vetën e tyre bërja e asaj që është më e vështiri. Dhe me këtë pretendim ata, janë munduar ta tregojnë vetën e tyre më të ditur, më të sinqertë, më sakrifikues, më solidar, më bujar, dhe më besimtarë të forte dhe më të sinqertë.

Ndërsa Pejgamberi a.s muslimanët që i ka pasur afër, gjithmonë i ka urdhëruar ta “lehtësojnë” fenë Islame e jo ta vështirësojnë. Atëherë ajo që u përket besimtarëve të sinqertë është bindjen e këtij urdhrit, dhe mos tua tregojnë njerëzve të vështir atë që është e lehtë. Në lidhje me këtë temë një thënie e Pejgamberit a.s është kështu:

“Lehtësoni, mos vështirësoni, përgëzoni, mos urreni, kaloni mirë me njëri tjetrin dhe mos bini në mosmarrëveshje”.

Prandaj ky libër është shkruar me qëllimin që njerëzve t’ua përkujtoj dhe këtë thënie të Pejgamberit a.s dhe lehtësinë e zbatimit të fesë Islame. Përveç kësaj ky libër njofton edhe se feja Islame është lloji më i përshtatshëm i jetesës së lumturisë, qetësisë, kënaqësisë, bujarisë, mirësisë, solidaritetit, krijimit të njeriut dhe se jeta që vazhdohet duke iu nënshtruar moralit të Kur’anit është jeta më e bukur që do të jetë për një njeri në këtë botë.

KUR'ANI, ËSHTË NJË UDHËZUES QË TË DËRGON KAH E LEHTA

Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty. Ta shpallëm vetëm këshillë (përkujtim) për atë që frikësohet. (Ta Ha, 2-3)

Allahu gjatë gjithë historisë së njerëzve për ta gjetur të vërtetën, të drejtën dhe për të fituar njohuri në lidhje me fenë, njerëzve u ka dërguar libra të shenjta, dhe në të njëjtën kohë për sqarimin dhe përcjelljen e këtyre librave në mesin e tyre ka dërguar pejgamber. Në mesin e këtyre librave të shenjta që kanë zbritur nga ana Allahut gjendet edhe Kur'ani Famëlartë. Kështu që Kur'ani është libri i fundit i shenjtë që ka zbritur për udhërrëfimin e mbar njerëzimit. Allahu veçorinë e udhërrëfyesit në një ajet Kur'anor e tregon e kështu:

Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe Furkanin (*dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtra*). S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e All-llahut i pret ndëshkimi i rreptë. All-llahut është ngadhënjyes, shpagimtar. (Ali-Ëmran, 4)

Të gjitha librat që i ka zbritur Allahu para Kur'anit, janë falsifikua dhe kanë pësuar ndryshime nga ana e njerëzve, mushrikëve dhe armiqve të fesë. Dhe si rrjedhojë e kësaj, këto libra e kanë humbur

origjinalitetin e tyre duke iu shtuar dhe bashkangjitur shumë besëtytni, shumë fjalë të kota, të padobishme dhe të pavlefshme. Ndërkaq libri i fundit Kur'ani Kerim deri më tani nuk ka pasuar ndonjë ndryshim dhe që nga tani e më tutje nuk do të ketë ndonjë ndryshim. Sepse Allahu është betuar se atë, do ta mbroj deri në ditën e kiametit dhe se nuk do ti lë njerëzit, mushrikët (politeistet), mynafikët (dyftytrëshit), armiqtë e fesë apo dike tjetër ta ndryshoj edhe një shkronjë të vetme në këtë libër hyjnorë. Allahu këtë të vërtet në Kur'an e tregon kështu:

Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij. (Hixhr, 9)

Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit. (Fussilet, 42)

Siç u pa nga ajetet Kur'anore, Allahu qenka mbrojtësi i Kur'anit. Për këtë arsye Kur'ani është një libër i vërtet që në te, nuk do të ketë ndryshime gjersa të ketë natë dhe ditë në këtë sipërfaqe të tokës. Në të njëjtën mënyrë edhe urdhrat edhe ligjet edhe këshillat që gjenden brenda tij, janë të vlefshme deri në ditën e kiametit. Sepse urdhrat, ligjet dhe këshillat e Kur'anit janë për të gjitha kohërat. Andaj nënshtrueshmëria dhe zbatimi i ligjeve, urdhrave dhe këshillave të Kur'anit për një njeri është një dhunti dhe marsi e madhe që atij i është dhënë nga ana e Allahut. Kështu që Allahu rëndësinë e Kur'anit për besimtarët në një ajet Kur'anor e tregon kështu:

“... Ne ty ta shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për muslimanët” (Nahl, 89)

Çdo njeri që e mëson dhe e bënë udhërrëfyes dhe këshilltarë të vetës së tij Kur'anin, do ta mësoj në mënyrën më të mirë qëllimin e krijimit të tij, qëllimin e ardhjes së tij në këtë botë, rrugën e fitimit të xhennetit, dashurisë, rahmetit, mëshirës, dhe kënaqësisë së Allahut, po edhe në të njëjtën kohë ai do të mëson edhe atë se çfarë kërkon Allahu prej njerëzve, çfarë duhet të bëjnë njerëzit gjatë gjithë jetës së tyre në këtë botë, cilat vepra duhet vepruar, cilat vepra nuk duhet vepruar,

fshehtësitë e krijimit, moralin më të mirë dhe shumë shumë gjëra tjera të vërteta.

Njeriu përveç këtyre, nga Kur'ani mund të mësoj edhe përgjigjet e pyetjeve në lidhje me fenë që mund ti parashtrihen nga ana e njerëzve vetës së tij. Sepse në Kur'an çdo pyetje në lidhje me fenë e ka përgjigjen. Allahu në Kur'an thotë:

Dhe ata nuk të sjellin ndonjë shembull ty, e që Ne të mos ta tregojmë të vërtetën, duke të ofruar shpjegim të qartë e të plotë (Furkan, 33)

Sikurse jepet njohuri me ajetet Kur'anore për çdo gjë në lidhje me fenë, edhe në të njëjtën kohë nuk është lënë asnjë temë që njerëzit në lidhje me atë temë të përçahen në mesë vetës. Duke u nisur nga kjo Allahu në një ajet Kur'anor tregon se njëra nga shkaqet e zbritjes së Kur'anit është edhe sqarimi i temave për të cilat njerëzit ishin përçarë në mes veti:

Ne nuk ta shpallëm ty për tjetër Kur'anin, vetëm që t'u sqarosh atyre atë për çka u përçanë, e (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë. (Nahl, 64)

Në ajetin e më sipër përmendur njoftohet se, Kur'ani për besimtarët e devotshëm që e kanë besuar Allahu, është një udhëzim e mëshirë dhe se ai për çdo temë është sqarues dhe rrugë tregues.

Kështu që Allahu me anë të Kur'anit neve na njofton me njohuri të ndryshme që sikur mos të kishte qenë Kur'ani, kurrë nuk kemi pas mundësi me i ditë. Shembull: Kur'ani jep njohuri për ekzistimin e shejtanit, për veçorit të tij, për qëllimet e tij, për dinakërinë e tij, për metodat precize që i përdorë për mashtrimin e njerëzve, për karakterin tinëzarë të tij, prej ç'far drejtimeve mund t'u afrohet njerëzve dhe shumë njohuri tjera. Përtej kësaj ai, njeriut ia tregon rrugën se si do të mund të shpëtoj nga kurthet, vesveset, dyshimet, pëshpëritjet, dhe ndikimet e shejtanit. Prandaj është një lehtësi e madhe për njerëzit që në saje të Kur'anit të bëhen vigjilent përballë një armikut të tillë sikur

shejtani, që u afrohet vetës së tyre në mënyra të fshehta. Dinakëria e tij është aç e madhe sa që mund ti mashtroj shumë lehtë ata që e kanë besimin e dobët dhe të luhatshtëm. Dhe në ditën e llogaris shejtani do t'u thotë atyre që e kanë ndjekur rrugën e tij kështu: **“Pse me keni ndjekur! A mos ju kam shti me zor me e ndjek rrugën time”**.

Kur'ani është shumë i qartë dhe është një libër që i thirr (fton) të gjithë njerëzit që të jenë të kujdesshëm ndaj dispozitave, obligimeve dhe ligjeve të fesë. Kështu që si hallalli (e lejuara), si harami (e ndaluara), dhe të gjitha temat tjera në lidhje me fenë janë sqaruar. Prandaj njerëzit në ditën e mahsherit gjersa janë duke dhënë llogari për atë që e kanë vepruar në jetën e kësaj bote, nuk do të kenë mundësi të thonë “kjo temë nuk na është komunikuar”, “kjo gjë nuk na është njoftuar”.

Andaj Allahu me anë të Kur'anit, njerëzit i ka paralajmëruar për gjërat e lejuara, për gjërat e ndalura, për obligimet tjera fetare që i përkasin çdo muslimanit dhe në të njëjtën kohë ua ka tërhequr vëmendjen që duke bërë sa më shumë vepra të mira ta largojnë edhe vetën e tyre po edhe familjet e tyre nga dënimi dhe ndëshkimi i zjarrit tmerrues të xhehennemit.

O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (*zjarrin*) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar. (Tahrim, 6)

Të kuptuarit e Kur'anit nuk është i vështirë. Sepse stilin, modelin, dhe mënyrën e kuptuarës së tij Allahu e ka bërë të lehtë për mbar njerëzimin. Allahu në lidhje me këtë në Kur'an thotë:

Ne u sollëm atyre (*mekasve*) një libër (*Kur'anin*) që ua shkoqitëm në baza të diturisë, është udhërrëfyes e mëshirë për ata që besojnë. (A'rafë, 52)

... Shih se si i sqarojmë faktet në mënyrë që të kuptojnë”. (Enam, 65)

Edhe pse ajetet Kur'anore janë të qarta, përsëri njerëzit mendojnë se Kur'ani nuk është i kuptueshëm. Përveç kësaj edhe shumica e njerëzve pretendojnë se nevojitet një arsim shumë i gjatë me vite për leximin, kuptimin dhe jetimin e Kur'anit. Mirëpo me të vërtet ata që e thonë një gjë të tillë, nuk e kanë lexuar bile edhe asnjëherë Kur'anin. Ose, e kanë lexuar por nuk kanë provuar ta kuptojë; ose ende duke qenë në fillim ia kanë kushtëzuar vetës së tyre me atë që nuk do të mund të kuptojnë atë. Ndërkaq Kur'ani, siç tregohet edhe në ajetet Kur'anore është një libër krejtësisht i qartë. Andaj çdo njeri që e lexon me sinqeritet atë, do të vëren se është posedues i një stilit dhe formës së lehtë të kupëtuarjes.

Prandaj është një mirësi dhe dhunti e madhe për njerëzit stili, forma, mënyra dhe gjuha e letë e kupëtuarjes së Kur'anit. Allahu lehtësinë e kupëtuarjes së Kur'anit nga ana e njerëzve në një ajet Kur'anor e tregon kështu:

Ne e bëmë atë (Kur'anin) të lehtë me gjuhën tënde vetëm që me të t'i përgëzosh të devotshmit, dhe me të t'i tërheqish vërejtjen një populli që është kryeneç. (Merjem, 97)

Në këtë mënyrë, ajo që i përket njeriut është nënshtrimi dhe mendimi mbi atë që e ka komunikuar Allahu në Kur'an. Mirëpo disa njerëz nuk e mendojnë një gjë të tillë. Prandaj nga që nuk e mendojnë një gjë të tillë gjithmonë e preferojnë atë që është e vështirë. Dhe në këtë mënyrë ata, duke kërkuar rrugë të gabuara dhe besime të kota, jetojnë larg Kur'anit i cili është arsye për shpëtimin e përhershëm të tyre. Kështu që siç tregohet në një ajet Kur'anor, Pejgamberit a.s Allahut i është drejtuar në këtë mënyrë:

E i dërguari tha: “O Zot im, vërtet populli im e konsideroi këtë Kur'an si (diç) të hedhur!” (Furkan, 30)

Ndërsa ata të cilët i kanë besuar Allahut me zemër të plotë, e dinë se Kur'ani nuk është i hedhur dhe e din se ai, është një udhëzues, udhërrëfyes dhe këshilltar i zbritur nga ana e Mëshiruesit,

Mëshirëbërësit Allahut. Dhe për këtë arsye Allahu ka njoftuar se Kur'ani “... është shërim dhe mëshirë për besimtarët” (Ësraë, 82). Nuk duhet të harrojmë se me ajetet Kur'anore zhduken dyshimet dhe pyetjet që do të mund të formohen në mendjen e njeriut dhe në këtë mënyrë njeriu për vetën e tij e mëson mënyrën më të përshtatshme të moralit dhe jetesës.

Kjo pik që do ta cekim është shumë me rëndësi: Njerëzit në rast se e jetojnë natyrshmërinë e Islamit, gjithmonë do të jetojnë të lumtur, të gëzuar, të qetësuar, të toleruar, të entuziazmuar, të shëndoshë, të drejtë, të mençur dhe të dalluar nga të tjerët. Kështu që e kanë të kotë ata që përpiqen t'i fitojnë këto gjëra jashtë rrugës së Kur'anit. Dhe si rrjedhojë e kësaj, edhe nëse mundohen me vite të tëra, asnjëherë nuk do të mundë ta gjejnë lumturin dhe qetësinë shpirtërore e trupore jashtë Kur'anit. Prandaj përshtatja dhe të nënshtruarit e Kur'anit për njeriun, është rruga e vetme e lumturisë dhe e qetësisë, si në këtë botë po ashtu dhe në botën tjetër. Nga kjo që thamë deri më tani del në shesh se Kur'ani është i vetmi “libër” i vërtet, i cili njerëzit i nxjerr nga errësira në dritë. Këtë e dëshmon edhe Allahu në këtë ajet Kur'anor kështu:

Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzi prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqiplotit, të Falënderuarit. (Ibrahim, 1)

Ata që i nënshtrohen dritës hyjnore të Kur'anit dhe u përshtaten urdhrave, ligjeve dhe këshillave të tij - me lejen e Allahut- si në këtë botë ashtu dhe në botën tjetër, gjithmonë do të përballohen me lehtësi dhe do të jetojnë një jetë të rehatshme të qetë dhe të bukur.

ALLAHU KA URDHËRUAR ATË QË ËSHTË E LEHTË

Shumë njerëz të dhënat ose njohurit që i kanë në lidhje me fenë, që nga fëmijëria ia kanë mësuar nga të afërmit e tyre ose nga rrethi i tyre ku jetojnë. Prandaj ata njohurit dhe të dhënat e fesë nga që nuk i kanë mësuar nga burimi i vërtet i fesë Kur’ani, çdoherë kapen pas shumë besëtytnive dhe shumë fjalë të kota, të padobishme dhe të pavlefshme.

Gjatë gjithë historisë, personat që kanë synuar devijimin e fesë së vërtetë nga thelbi, duke përdorur metoda të ndryshme për pengimin e jetesës dhe përshtatjes së fesë, gjithmonë janë munduar t’i shtojnë disa besime të kota dhe zbatime të vështira fesë. Kështu që ata për arsyen e zbatimit të atyre që i kanë shpikur nga vetja e tyre duke i ditur ose duke mos i ditur, janë bërë shkaktar të larguarës së njerëzve nga feja. Ndërsa neve libri i Allahut (Kur’ani) dhe Sunneti (rruga, tradita) i Muhamedit a.s na tregojnë se jetesa e fesë është shumë e lehtë për njerëzit e sinqertë dhe të devotshëm.

Në radhë të parë duhet ta cekim atë që; Allahu sikur çdo gjë tjetër në gjithësi, edhe njeriun e ka krijuar nga asgjëja. Prandaj Allahu është Ai që më së miri e njeh njeriun dhe është më afër tij se damari që e ka

në qafën e tij. Dhe si rrjedhojë e kësaj edhe fenë e ka bërë të përshtatshme me krijimin e njeriut. Në një ajet Kur'anor Allahu njeriun e thërret për në atë që është më e përshtatshme për natyrshmërinë (krijimin) dhe fenë e tij.

Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Rrum, 30)

Allahu me mëshirën dhe rahmetin e Tij të pafund, të gjitha fetë e vërteta që i ka dërguar gjatë shekujve kanë qenë poseduese të ligjeve që mund të zbatoheshin shumë lehtë. Sepse Allahu për njerëzit gjithmonë ka dëshiruar lehtësi dhe këtë të vërtetë e ka komunikuar dhe në Kur'an duke thënë: **“(Allahu) dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju...”** (Bekare, 185). Një njeri që u përshtatet dispozitave të Allahut në të njëjtën kohë është edhe një njeri që e jeton një jetë shumë të bukur, që është e përshtatshme me natyrshmërinë (krijimin) e tij.

Kurse një pjesë e njerëzve që nuk e dinë këtë të vërtetë mendojnë se do të jetë më e lehtë feja në rasë ngrehen dispozitat e saj. Shembull: Ata mendojnë se do të jetojnë të lirë dhe të pavarur kur nuk u jepet rëndësi vlerave të moralit. Ose pretendojnë se feja do tu sjellë disa sekuestrime që do t'ua vështirësoj jetesën. Ndërkaq të gjitha këto janë gabime të mëdha që njerëzit i kanë rrëmbyer dhe janë mashtrome të shejtanit. Sepse të jetuarit e fesë së Allahut dhe zbatimi i urdhrave që gjenden brenda saj është shumë i lehtë. Kurse ajo që është e vështirë, është të jetuarit në një shoqëri që përbëhet prej njerëzve që nuk i njohin dispozitat, urdhëratë, dhe ligjet e Allahut. Një jetesë e tillë, sjellë një përfundim të keq.

Veçanërisht në shoqëritë që jetojnë larg fesë ose në shoqëritë e njerëzve të pa fe, gjithmonë ka kaos, prishje të rregullit, prishje të

rendit, mosrespektim të ligjeve, mosmarrëveshje, shqetësime, brengosje, frikë, mungesë lumturie, dhe mungesë qetësie. Andaj njerëzit që u përkasin këtyre shoqërive nga që nuk fiksohen prej Allahut janë në gjendje të gënjejnë, të mashtrojnë, të tradhtojnë, të vjedhin, të plaçkitin, të pinë alkool, të bëjnë zina, të shajnë, të fyejnë, të hajn hakun e njëri tjetrit, e shumë shumë gjëra tjera të ndyta që janë në kundërshtim me dispozitat e fes Islame. Ata duke mos ditur se çka është solidariteti, sakrifikimi, toleromi, dashuria, mirëkuptimi, respektimi, marrëveshja, kuptuara, ndihma ndaj njëri tjetrit, përkrahja e njëri tjetrit nga ana shpirtërore dhe materiale, vazhdojnë të jetojnë një jetë degjeneruese. Prandaj një jetë e tillë njeriut nuk i sjellë asnjëherë lumturi. Kështu që nëse në një vend ngrehen dispozitat e fesë atëherë në shesh del krejtësisht e kundërta e ambientit që do ta gjej njeriu lumturin dhe si rrjedhojë e kësaj ashtu siç dëshiron shejtani formohet një ambient i përngjashëm me xhehennemin.

Për shembull: Shembujt e ngjarjeve që i hasim më së shumti në ditët e sotme kanë të bëjnë me përdorimin e drogës, përhapjen, shpërndarjen, shitjen e saj, kurvërinë, ryshfetin, falsifikimin, gënjeshtërinë, mashtrimin, tradhtinë, përdorimin e alkoolit etj... Të gjitha këto që i përmendëm janë krejtësisht larg dispozitave të fesë dhe në të njëjtën kohë janë edhe larg bukurisë, qetësisë, rahatisë, lumturisë dhe vlerave të ndryshme shpirtërore. Kështu që njerëzit në atë ambientin ku përdoren këto gjëra mendojnë se janë të lirë dhe të pavarur nga çdo gjë. Andaj në përdorimin e tyre nuk njohin kufi. Ama ata harrojnë që fatkeqësia shpirtërore dhe materiale që u vjen vetës së tyre në saje të përdorimit të këtyre gjërave është më e madhe prej parandjenjave që i pretendojnë të lira. Mendojeni se çfarë do të mund të jetë fitimi i atyre personave që u është prishur shëndeti prej alkoolit, prej zinas, prej drogës, ku në saje të këtyre u është rruddhur edhe lëkura, u është prishur trupi, janë plakur më herët se ç' duhet? Pa dyshim që mosnjohja e

dispozitave të fesë në çdo gjë, konsiderimi i moralit të fesë si asgjë, dhe vazhdimi i një jete pa qëllim duke bërë punë të ndyta që janë në kundërshtim me dispozitat e fesë, pa përjashtim të çdo njeri sjellin shkatërrime të mëdha fizike dhe shpirtërore. Por edhe më tepër këto përfundime mund ti shohin të gjithë dhe janë aq të çarta saqë nuk mund ti mohon askush.

Andaj njeriu sado që të jetoj larg fesë aq më shumë do të jetoj një jetë të mjerë, të vështirë dhe jo të lumtur. Ndoshta ata persona që merren me punë të ndyta mund të jetojnë një jetë të qetë. Ama kurrë nuk do të mundë ta gjejnë lumturinë dhe qetësinë e vërtetë shpirtërore. Po edhe më tepër ai nga që i ka lënë pas dore urdhëratë dhe ligjet e Allahut në jetën e ahiretit do të ndjejë pendim (bëhet pishman) dhe do të përballohet me një jetesë që do ta jetojë vështirësinë e dhimbjeve, torturave dhe mundimeve më të mëdha.

Kurse njerëzit që fiksohen prej Allahut dhe i kryejnë obligimet e fesë pa mangësi, si në këtë botë po ashtu dhe në botën tjetër janë brenda një përfitimit të madh. Ata para çdo gjëje e jetojnë edhe qetësinë e ndërgjegjes dhe kënaqësinë shpirtërore të bindjes në Allahun. Për ata persona gjithmonë ka bukur dhe myzhde. Kështu që Allahu u jep myzhde në këtë mënyrë atyre personave që u përmbahen dispozitave të Tij dhe atyre personave që i nënshtrohen mëshirë së Tij:

(Të xhennetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falënderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe përmbushin dispozitat e All-llahut. Pra, përgëzoi besimtarët. (Tevbe, 112)

E ata që tregojnë lëshim të dispozitave të Allahut do të jetojnë një jetë të vështirë me brenga dhe shqetësime si në këtë botë po ashtu dhe në botën tjetër dhe në të njëjtën kohë vetëm vetveten e vet e dëmtojnë. Allahu thotë:

“... Këto janë dispozitat e All-llahut, e kush del jashtë dispozitave të All-llahut, ai e ka dëmtuar vetveten...” (Talakë, 1).

Disa njerëz vetëm që mos t’ju nënshtrihen dispozitave të Allahut përpiqen t’i ndryshojnë ato. Ama me të vërtetë kjo përpjekje nuk buron nga mendja e njerëzve, por nga shejtani. Kështu që kjo është një kurth e shejtanit që njerëzit bëhen viktimat e sajë. Shejtani i mallkuar gjithmonë përpiqet që punët e lejuara njerëzve tua tregoj si të lejuara dhe të ndaluarat tua tregoj si të lejuara. Dhe si rrjedhojë e kësaj njerëzit e mendojnë vetën e tyre më të lartë kur i lënë pas dore dispozitat e Allahut. Po edhe më tepër ata vetë mundohen të vendosin ligje mbi dispozitat e Allahut. Por edhe pse sipas vetës së tyre i vendosin këto ligje, përsëri nuk u tregojnë kujdes zbatimit të tyre. Në lidhje me këtë temë Allahu e jep shembullin e devijimit të katolikëve:

Pastaj vazhduam pas tyre me të dërguarit Tanë, e pas tyre e dërguam Isain, të birin e Merjemes dhe atij i dhamë Inxhillin, e në zemrat e ithtarëve të tij dhuruam butësi e mëshirë, ndërsa murgërinë ata vetë e shpikën. Ne atë nuk ua bëmë obligim atyre, mirëpo edhe pse kishin për qëllim me të vetëm ta arrijnë kënaqësinë e All-llahut, ata nuk iu përmbajtën asaj si duhet përmbajtur, prandaj atyre që besuan, Ne ua dhamë shpërblimin e tyre, po shumë prej tyre janë mëkatarë (*jobsimtarë*). (Hadidë, 27)

Për këtë arsye Allahu atyre që besuan ua ka tërhequr vëmendjen përballë këtij rrezikut dhe në Kur’an është komunikuar devijimi i atyre që e kanë tepruar në rrugën e Allahut kështu:

Thuaju: “O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë”. (Maide, 77)

Të vetmen gjë që duhet ta bëjë njeriu është kryera e urdhrave që Allahu obligimin e tyre e ka treguar në Kur’an dhe largimi i tij nga ato gjëra që ia ka ndaluar Allahu.

Kështu që ata që mundohet ta vështirësojnë fenë, në ditën e kiametit do të japin llogari për këtë gjë. Sepse gjersa Allahu fenë e ka bërë të lehtë ata mundohen ta vështirësojnë. Edhe Pejgamberi a.s në lidhje me fenë thotë:

Feja është e lehtë. Askush nuk mund ta ashpërson (të bëhet i ngurtë përballë) fenë. (Pra çdokush duhet t'i përshtatet lehtësisë së fesë, Sepse mbet i dobët ai që thotë ta mbajë të shtrënguar fenë). Ndreqeni lëvizjen e vijës tuaj dhe qëndroni afër cakut. (Haidthi Rumuz, vëllimi 1. faq. 98)

Njerëzit fenë, duhet ta vlerësojnë sipas thënies së pejgamberit a.s që e cekëm më lartë. Kështu që është një gabim shumë i madh të menduarit se zbatimi i dispozitave, obligimeve dhe ligjeve të fesë është i vështirë.

Lehtësitë që janë njohur në lidhje me ushqimet

Allahu njerëzve për tu ushqyer u ka dhënë shumë dhunti (të mira) të ndryshme. Këto dhunti të panumërta si pemët e llojllojshme, perimet e ndryshme, mishrat, pijet, si dhe ushqimet tjera te lezetshme i janë dhënë në shërbime çdo njeriut. Dhe Allahu me ajetin Kur'anor **“Të pyesin ty (Muhammed), çka u është lejuar atyre? Thuaju: “U janë lejuar të gjitha ushqimet e mira...”** (Maide, 4), ka njoftuar se njerëzve u janë lejuar të gjitha ushqimet e mira.

Kurse ushqimet që i ka bërë haram Allahu për njerëzit, janë si ushqime të ndyta sikurse mishi i dërrit, mishi i cofëtinitës, gjaku etj... Po edhe sido që të jetë këto ushqime janë të ndyta dhe të dëmshme për trupin e njeriut. Allahu në një ajet Kur'anor thotë kështu:

Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë, dhe pos asaj që është therur jo në emër të All-llahut (por të ndonjë

idhulli) e që është mëkat. E kush detyrohet (t'i hajë këto të ndaluara), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, Zoti yt është që falë e mëshiron shumë. (En'amë, 145)

Kështu që për ushqimet e ndaluara është shumë mësimdhënëse shprehja “ndyrësirë” që kalon në ajetin e më lartë përmendur Kur'anor. Sepse më të vërtetë mishi i derrit është posedues i veçorive që i shkaktojnë dëm trupit të njeriut.

Për shembull nëse e marrim mishin e derrit do ta vërejmë se është shumë i ndyrshëm. Andaj në rast se hahet mishi i derrit, yndyra e tij kalon në gjak. Atëherë kur yndyra kalon në gjak, shkaktohet rritja e sasisë së yndyrës së gjakut. Dhe si rrjedhojë e kësaj yndyra e tepërt që kalon në gjak bëhet shkak i forcimit të damarëve, i rritjes së tensionit dhe infarktimit në zemër. Megjithëkëtë edhe sipas normales duhet të punojnë më shumë gjëndrat e limfës për jashtëqitjen e lëndës helmues që quhet “sutuksin” e që gjendet brenda yndyrës së derrit. Kjo gjendje vetën e vetë veçanërisht e tregon në pezmatimin dhe fryrjen e limfës së fëmijëve. Përveç kësaj mishi i derrit përmban sasi të madhe të squfurit. Kështu që trupi kur merr sasi të madhe të squfurit, hapet rruga e sëmundjeve të ndryshme si e kartilazhit, pezmatimit të mushkërive, nervave, zorrës qorr, qelqëzimit... Afër këtyre, squfuri bëhet edhe shakatar i sëmundjeve serioze të lëkurës dhe të trishinit (Iloj virusi që mbetet tek njeriu nga ngrënia e mishit të derrit). Kjo sëmundje te njerëzit kalon vetëm nëpërmjet mishit të derrit dhe te njerëzit sjellë një gjendje vdekjeprurëse. (Këtu i treguam vetëm disa dëme të përgjithshme që vinë nga mishi i derrit).

Nga ajo që thamë deri më tani del në shesh se të ndaluarit e disa ushqimeve për njerëzit janë të dobishme dhe mbrojtëse nga gjërat e dëmshme për trupin e tyre.

Ndërkaq këtu është e dobishme të ceket edhe një pikë e rëndësishme: Pa dyshim që të qenit haram (e ndaluar) dhe hallall (e lejuar) është krejtësisht urdhër i Allahut. Dhe detyra e njeriut është t'i

nënshtrohet këtij urdhrit. Prandaj nëse dëshiron Allahu njerëzve ju tregon mirësitë e ndalimit të një ushqimit, po edhe nëse nuk dëshiron nuk ju tregon. Ama siç e përmendëm edhe më herët, Allahu mirësitë e ushqimeve të ndaluara njerëzve ua tregon në shumë raste. Dhe këto raste njerëzve ua lehtësojnë njohjen e ushqimeve të dëmshme. Dhe në këtë mënyrë zemra e besimtarëve qetësohet. Gjersa Allahu bënë fjalë në Kur'an për ushqimet e ndaluara në të njëjtën mënyrë bënë fjalë edhe se si duhet të sjellët njeriu përballë gjendjeve të ndryshme që mund t'i ndodhin atij. Në këtë mënyrë Allahu e ka ndaluar ngurrimin dhe dyshimin në gjendjet e vështira dhe të papritura. Në lidhje me këtë temë disa ajete Kur'anore janë kështu:

E ju (besimtarë), hani pra nga të mirat që ua dha All-llahu, të lejuara e të pastra, jini mirënjohës për dhuntitë e All-llahut, nëse jeni të sinqertë në adhurim vetëm ndaj Tij. Ai ua ndaloi juve vetëm cofëtinën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret jo në emër të All-llahut. E kush detyrohet (t'i hajë) duke mos qenë dhunues dhe duke mos e tepruar (në ngrënie), All-llahu fal dhe është mëshirues. (Nahl, 114-115)

Të përkujtuarit në fund të ajetit se Allahu është falës dhe mëshirues ka për qëllim qetësinë dhe myzhdenë që Allahu ua ka jep besimtarëve. Sepse njeriu është krijuar i dobët dhe i paaftë. Mund të gaboj, mund të harroj, mund të dalldiset pas një gjëje që i pëlqen, mund të sillet i pavendosur... Vetëm se Allahu do ta falë dhe do ta mëshirojë atë person kur i pendohet sinqerisht Atij.

Lehtësitë që Allahu ua ka dhënë atyre që falin namazin

Namazi është një ibadet (adhurim) që çdo musliman duhet ta kryej pa ndërprerë gjatë gjithë jetës tij. Mirëpo këtë ibadet (adhurim) shumë pak njerëz e kryejnë ose disa mendojnë ta lënë kryerjen e tij në ditët e pleqërisë, ose disa tjerë mendojnë se kryerja e këtij ibadetit (adhurimit)

është i vështirë. Ama edhe kryerja namazit sikur çdo ibadet (adhurim) tjetër është shumë i lehtë.

Duhet ta cekim atë që: njeriu është i obliguar vazhdimisht ta kryej ose ta zbatoj këtë obligim që ia ka caktuar Allahu. Andaj nëse mundohet ta kryen këtë obligim shpresohet se do ta fitoj mëshirën, dashurin, faljen dhe xhennetin e Allahut. Kurse lehtësia që gjendet në ibadete (adhurime) shfaq dukjen e mëshirës dhe dashurisë së Allahut. Andaj për ata persona që nuk i zbatojnë obligimet e Allahut, në ditën e kiametit nuk do të ketë asnjë ndjesë në lidhje me atë që nuk e kryer. Në të njëjtën kohë edhe nuk do të mund të ankohen se kanë qenë të vështira kryerja e ibadeteve (adhurimeve).

Për shembull: marrja e abdesit është bërë shumë e lehtë. Madje edhe nëse nuk gjendet ujë, Allahu njerëzve për abdes ua ka treguar rrugën e “tejmumit” (të marrit abdes me pluhur). E pa dyshim që marrja e tejmumit është e lehtë për çdo person. Allahu në një ajet Kur’anor se si do të marrin tejmum ata që nuk kanë gjetur ujë e komunikon kështu:

O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë. Nëse jeni xhunubë, atëherë pastrohuni (lahuni)! Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyjeni (merrni tejmum) dheun e pastër dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja. All-llahu nuk dëshiron (me obligim për abdest e larje) t’ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë (prej mëkatëve), t’ua plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni. (Maide, 6)

Siç u tregu në ajetin Kur’anor Allahu njerëzve nuk u dëshiron tu sjellë asnjëherë vështirësi në kryerjen e ibadeteve (adhurimeve). Po edhe në Kur’an tregohet se në çdo temë ka lehtësi për njerëzit. Andaj

janë shumë të lehta për ata që kanë besuar ibadetet (adhurimet) që i ka urdhëruar Allahu për njerëzit.

Kështu që Allahu me mëshirën dhe rahmetin e Tij të pafund, për njerëzit e ka komunikuar mënyrën e kryerjes më të mirë, më të lehtë të ibadeteve (adhurimeve) dhe ata që e kryejnë këtë ibadete (adhurime), i ka pagëzuar me dashuri, mëshirë dhe me xhennet.

Shkurtimi i namazit në luftë

Në Kur'an ka lehtësi që janë treguar për periudhat e caktuara. Shembull; Në periudhën e Pejgamberit a.s Allahu u ka treguar lehtësi për kryerjen e ibadeteve atyre besimtarëve që kanë qenë në çastet e luftës së rrebet me shoqëritë injorante (jobesimtare). Kështu që në Kur'an është komunikuar se në çastet e luftës ose ne gjendjet e domosdoshme besimtarët do të mund ta shkurtojnë faljen e namazit:

Kur të jeni në udhëtim e sipër, nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, (ose) nëse frigoheni se jobesimtarët do të ju sjellin ndonjë të keqe (në luftë). Jobesimtarët janë armiq tuaj të hapët. (Nisa, 101)

Nga ky ajete Kur'anor kuptohet se, secili urdhër dhe secili ligj i Allahut për secilin besimtar veç e veç është i mbushur me mirësi dhe urtësi. Allahu nuk dëshiron vështirësi për robërit e Tij. Allahu është edhe mbrojtësi i vetëm po edhe miku më i vërtet i besimtarëve.

Lehtësia që është treguar për agjërim

Allahu të gjithë muslimanët i ka obliguar që ta agjërojnë muajin e ramazanit. Ky agjërim shumë njerëzve u duket i vështirë, mirëpo në të vërtet nuk është aspak i vështirë, sepse Allahu sikur obligimet tjera që i ka bërë të lehta edhe këtë obligim në të njëjtën mënyrë e ka bërë të lehtë. Përveç kësaj edhe Allahu agjërimin e ka lehtësuar në gjendjet e jashtëzakonshme. Si rrjedhojë e kësaj Allahu në ajetin 185'së të Sures

Bekare ka treguar se kush e përjeton muajin e ramazanit duhet të agjëroj dhe e si lehtësi për ata që janë të sëmurë ose janë në udhëtim ua ka bërë të mundshëm të agjërojnë më vonë:

(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) **Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni. (Bekare, 185)**

Siç u tregua në fund të ajetin Kur’anor, Allahu nuk kërkon ndonjë vështirësi për njerëzit. Prandaj të përkujtuarit se Allahu dëshiron lehtësi për njerëzit në fund të ajetit Kur’anor tregon se nevojitet të kuptohet duke sjellë në mend dhe lehtësinë e obligimeve tjera të fesë. Si rrjedhojë e kësaj, janë brenda një mashtrimit të madh ata që ikin dhe largohen nga kryerja e obligimeve të fesë duke i pretenduar se janë të vështira zbatimet e tyre dhe në të njëjtën kohë ata, fenë nuk e kanë të çartë.

Allahu nuk ju ka ngarkuar përgjegjësi

Allahu me mëshirë dhe rahmetin e tij të pa fund, disa njerëz nuk i ka ngarkuar me përgjegjësi sikur i ka ngarkuar me përgjegjësi të tjerët. Allahu këtë në ajet që do ta përmendim më vonë këtë e tregon kështu:

Nuk është mëkat (të ngelë pa dalë) për të verbërinë, për të çalin, e as për të sëmurin. E kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, Ai atë e shtie në xhennete ku rrjedhin lumenj, e kush mbetet prapa, Ai atë e ndëshkon me një dënim të dhembshëm. (Fet-h, 17)

Siç u tregohet në ajetin Kur’anor Allahu nuk i ka ngarkuar me përgjegjësi njerëzit me të meta. Në këtë ajet Kur’anor vërehet mëshira,

dashuria e pa kufizuar e Allahut që ka për njerëzit po edhe në të njëjtën kohë vërehet edhe lehtësia për njerëzit që janë me të meta. Kurse në një ajet tjetër Kur'anor tregohet se Allahu njerëzit nuk i ka rënduar dhe në saje të kësaj Ai e ka shprehur mëshirën dhe rahmetin e madh që e ka mbi njerëz:

“... E sikur të dëshironte All-llahu do t’ju rëndojë. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.” (Bekare, 220)

Lehtësia që tregohet në betimet e paqëllimta

Të betuarit, në përgjithësi është një sjellje e përhapur që është bërë ves i gjuhës në mesin e njerëzve. Kështu që njeriu me këtë ves të tillë mund të betohet gjersa i jep fjalën dikujt për diçka. Kurse besnikëria për fjalën e dhënë dhe mbajtja e fjalës janë veçori të besimtarit që Allahu i ka urdhëruar në Kur'an. Ndërkaq njeriu mund të gaboje se është një krijesë harrese dhe për këtë arsye ai nganjëherë mund të harrojë punën që do ta bëjë ose mund ta harrojë fjalën që i ka dhënë dikujt. Kjo është shumë e natyrshme, sepse ky është një gabim pa dashje që del në shesh prej dobësisë së njeriut. Padyshim që në ahiret do të pyetet besnikëria e besimtarëve por ata njerëz që betohen pa qëllim Allahu nuk i ka mbajtur përgjegjës në ahiret. Kjo gjë në Kur'an tregohet kështu:

All-llahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. All-llahu është i butë dhe falë shumë. (Bekare, 225)

Përveç kësaj është edhe një lehtësi tjetër në çështjen e betimit. Kjo rrugë e lehtësisë është për ata pësona që betohen në emër të Allahut por pastaj me vetëdije të plotë dëshirojnë ta prishin betimin. Kështu që rrugë zgjedhja e kësaj është shpagimi. Allahu thotë:

“All-llahu ua ka përcaktuar juve zgjidhjen e betimeve tuaja...” (Tahrim, 2)

“All-llahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet e juaja të paqëllimta (për betim), por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht. E shpagimi i tij (i betimit të bërë) është duke i ushqyer dhjetë të varfër me ushqim mesatar që ushqeni familjen tuaj, ose duke i veshur ata (të dhjetë), ose duke liruar një rob. E kush nuk ka mundësi t’i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagim për betimet tuaja kur i thëni ato. Ruani betimet tuaja. Kështu All-llahu ju sqaron dispozitat e veta, ashtu që të jeni mirënjohës” (Maide, 89)

Siç u kuptua nga ajetet Kur’anore, Allahu ne dy gjendjet ka treguar lehtësi të përshtatshme në fe për veprimin e njerëzve. S’ka dyshim që mbajtja e betimit është me e drejt dhe më e bukur. Vetëm se njeriu ose mund ta harrojë fjalën e dhënë ose mund të ndryshojnë kushtet në periudhën ku e ka jep fjalën ose mund të bie në një situatë aç të vështirë saqë nuk mund ta mban fjalën. Kështu që Allahu duke dëshiruar lehtësi për njerëzit e ka treguar rrugë e shpagimit për betimin dhe në këtë mënyrë për çdo gjë ka treguar rrugë dalje.

Prandaj Allahu fenë e ka bërë shumë të lehtë. Feja Islame, është fe e lehtësisë për çdo çështje dhe për çdo gjë. Njeriu kur synon të bëhet fetar i mirë dhe një rob falënderues i dhuntive të Allahut asnjëherë nuk do të përballohet me ndonjë vështirësi në lidhje me zbatimin dhe jetimin e fesë.

SPROVA QË KA KRIJUAR ALLAHU ËSHTË SHUM E LEHTË

Gjatë gjithë jetë së tyre njerëzit që jetojnë larg moralit të fesë për vetën e tyre caktojnë synim të ndryshme. Por në përgjithësi pika kryesore e këtyre synimeve është e orientuar kah ambiciet e kësaj bote. Për shembull: Të bërit një doktor i specializuar, një inxhinier i suksesshëm, një baba i mirë, një biznesmen i famshëm, një pasanik i madh, një artist i njohur në botë dhe të ngjashme me këto, mund të njihen si synimet më kryesore të shumicës së njerëzve. Përveç këtyre edhe shumica e njerëzve në fusha të ndryshme përpiqen të arrijnë sukses, lumturi dhe vullnet për të realizuar një jetë të qetë. Kurse një shumicë tjetër duke bërë sakrifikime të ndryshme “mundohen të arrijnë me një vend”. Ndërkaq ata kur zhyten në një mënyrë të tillë pas këtyre gjërave, e harrojnë qëllimin e tyre në këtë botë ose bëhen kisha nuk e dinë.

Me gjithë këtë një njeri nuk duhet ta harrojë qëllimin e tij në këtë botë duke u mashtruar pas ambicieve mashtruese dhe dëfryese të dynjasë. Po edhe më tepër ata nuk duhet harruar që vetës së tyre ti bëjnë disa pyetje. Si për shembull: “Pse kam ardhur në këtë botë?”, “Cili është qëllimi i ekzistencës time?”. Pastaj, u bëra një inxhinier i

mire dhe e bëra projektimin e shumë ndërtesave, u bërë i pasur, u bërë zotërues i një pune të mirë dhe në saje të kësaj fitova mjaft para, fitova një titull dhe u bëra i njohur në botë, por të gjitha këto mua çka më përfituan? Cilave prej këtyre do tu mbetet një kuptim pas vdekjes? Çfarë dobie do të më sjellin mua në ahiret ato që i kamë lënë në sipërfaqen e tokës? Ekzistenca a është e përbërë vetëm nga kjo jetë a po edhe nga ndonjë jetë tjetër? Pra këto duhet të jenë disa pyetje që çdo njeriu duhet t'ia pyet vetë vetës së vetë para se ti vi vdekja.

Mirëpo nuk duhet harruar atë që; njerëzit sigurisht duhet të bëhen zotërues së profesioneve të ndryshme, madje edhe duhet të përpiqen dhe mundohen të bëhen shumë shumë të suksesshëm në profesionet e tyre. Por shumica e njerëzve gjersa mundohen të bëhen të suksesshëm në profesionin e tyre e harrojnë qëllimin e vërtetë të jetës së tyre dhe gjithë jetën e tyre ua kushtojnë standardeve të përkohshme jetësore.

Ndërkaq nëse çdo njeri mendon vetëm pakë, do të arrin ta kuptojë të vërtetën se; Allahu njeriun dhe dynjanë e ka krijuar mbi një qëllim të caktuar. Qëllimi i krijimit të njerit siç tregohet edhe në Kur'an është të bërit ibadet (adhurim) Allahut. Kurse qëllimi i krijimit të dynjasë, është të qenit e sajë një vendit i sprovës për përcaktimin e vendbanimit dhe situatës së njerëzve në ahiret. Allahu këtë të vërtetë në Kur'an e tregon kështu:

Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepër mirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkat falësi. (Mulk, 2)

Allahu njerëzve u ka dhënë shumë dëshmi për ta kuptuar se jeta e kësaj bote është e përkohshme dhe se vendi i vërtetë ku do të banojnë përgjithmonë është në ahiret.

Shembull: si ekzistimi i qindra sëmundjeve në këtë botë, ekzistimi i viruseve që mund të kenë ndikim vdekjeprurës në trupin e njeriut që është me miliarda kat më i madh se virusi, pastrimi i vazhdueshëm i

njeriut, uria, ngrënia e ushqimit, pushimi, nevoja për fjetje, të qenit jetëgjatësia mesatare 60-70 vite, të qenit e kohës si bërës i një gjeje të njeriut, ekzistimi i vdekjes fund i pashmangshëm për askënd, lërja mbrapa mallin, paranë, prestigjin, autoritetin dhe shumë gjërave tjera që janë fituar në këtë botë, kalbja e trupit të njeriut pasi të varroset, dhe shumë shumë shkaqe tjera janë të mjaftueshme për ta kuptuar njeriu se kjo botë është e mbushur me dobësi të përkohshmërisë dhe se është një vend që shpirti i njeriut kurrë nuk do të mundë ta gjejë në te lumturin dhe ngopjen. Të gjitha këto janë të vërteta shumë të rëndësishme që e pengojnë njeriun të lidhet për këtë botë. Allahu në Kur'an tregon se këtë botë nuk e ka krijuar “shkel e shko”, por ekzistencën e saj e ka krijuar për qëllime të caktuara:

Ne nuk e krijuam qiellin, tokën e çdo gjë çka ka mes tyre shkel e shko (pa qëllim të caktuar). Sikur të kishim dashur të zbavitemi dhe sikur të donim ta bënim atë, Ne do të zbaviteshim në kompetencën Tonë, por Ne nuk e bëmë atë. (Enbija, 16-17)

Prandaj njeriu nëse mendon vetëm pak, do ta kupton shumë lehtë se kjo botë nuk është një vend që do të qëndrojë përgjithmonë, se kjo botë është një vend i sprovës dhe se kjo botë nuk është stacioni i fundit, por në të kundërtën do ta kuptojë se është një vend i përkohshëm, se do të përgjigjet për çdo çast që e ka jetuar në këtë vend të përkohshëm dhe se më e rëndësishmja është ajo se e ka një përgjegjësi përballë Zotit që e ka krijuar nga mos ekzistenca.

Duke e kapërcyer një shkallë me përpara një njeri që e posedon një mendim të tillë duhet ta mendojë këtë: Allahu të gjithë njerëzit në këtë botë i sprovon me vështirësi, me kënaqësi dhe me situata të ndryshme. Të gjitha situata që njeriu përballohet brenda ditës, përbëhen prej sprovave të cilat e përcaktojnë vendin që do të gjendet në jetën e përhershme pas vdekjes. Dhe Allahu në këto sprova secilit njeri ia ka bërë të lehtë dhe atij ia ka treguar rrugën, pra i ka treguar se çka duhet të bëjë:

Vërtet ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka i përmendur. Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë. (Ënsan, 2-3)

Siç u tregua në ajetin Kur'anor, Allahu doemos në jetën e të gjithë njerëzve ka treguar rrugën që është më e drejtë për ata dhe në të njëjtën kohë atyre u ka krijuar kushte të përshtatshme që të bëhen zotërues së diturisë në lidhje me fenë dhe moralin e bukur. Prandaj në sajë të kësaj çdo njeri do të mund ta mësojë se kjo botë është e përkohshme dhe se vendi në ahiret përcaktohet në këtë vend të përkohshëm duke bërë vepra të mira që i pëlqen Allahu.

Kështu që është e shijshme dhe shumë e lehtë çdo sprovë që ka krijuar Allahu për besimtarët të cilët i besojnë Atij, të cilët i nënshtrohen Atij me një nënshttrim të plotë, të cilët e bëjnë mik dhe mbrojtës të vetës së tyre vetëm Atë, ata të cilët i mbështetën dhe orientohen kah Ai për çdo gjë dhe për çdo situatë. Për ata që e dine fshehtësinë e besimit dhe për ata që i kanë besuar sinqerisht Allahut në asnjë çast të jetë së tyre nuk ka vështirësi, hidhërim, pikëllim, dhimbje dhe vuajtje. Për ata, çdo situatë kthehet në mirësinë e afrimit të tyre te Zoti dhe në shpresën e sa më shumë të xhennetit.

Njëra nga kushtet e besimit të sinqertë është të njohurit Allahut. Sepse një njeri sa më shumë që e njeh Allahun, sa më shumë që e din forcën dhe mëshirën e Tij, aq më i qëndrueshëm i bëhet sinqeriteti dhe afërsia e tij ndaj Zotit. Për shembull: një njeri që e dinë falshmërisë e madhe të Allahut asnjëherë nuk mbërthehet në pesimizëm dhe në dëshpërime për shkak të gabimeve dhe mëkateve të tij. Një përsosë që beson se Allahu është dhënës i dhuntive, nuk bënë lakmi në çështjen e fitimit të parave apo pasurisë. Ai ngase e dine se Allahu është dhënës i dhuntive punon, përpiqet të fitojë të mira material, por përsëri e dinë se sasinë e dhuntisë ia ka caktuar Allahu dhe në të njëjtën kohë e jeton nën

shtrishmërinë e asaj që nuk do të mundë ta ndryshoj këtë. Si rrjedhojë e kësaj, jeta e kësaj bote për një njeri që e dine dhe njeh Allahun është e mbushur me mirësi dhe lehtësi të mëdha; ai çdo herë jeton duke e pare dukjen e Allahut në bukurit mahnitëse që i ka krijuar. Shkurtimisht për besimtarët e devotshëm që i janë nënshtruar me bindje të plotë Allahut është e shijshme dhe shumë e lehtë sprova që ka krijuar Allahu për ata.

Allahu është shumë falës

Mëshira dhe dashuria e madhe e Allahut për njerëzit është një mirësi e madhe. Sepse njeriu është një krijesë që mund të shkujdeset, që mund të harroj, që mund të gaboj, që mund të bëjë mëkate dhe që mund të mashtrohet lehtë. Për këtë arsye Allahu me mëshirën dhe dashurin e Tij të pakufizuar duke e ditur paaftësinë dhe dobësinë e njeriut, çdoherë atyre u ka njohur mundësi të kërkojnë falje dhe të pendohen sinqerisht për mëkatet ose gabimet e bëra. Andaj çdo njeri që kërkon faljen e mëkateve në një mënyrë të sinqertë me frikë që do të pësojë dënimin dhe ndëshkimin e Allahut mund të shpreson në faljen dhe mëshirën e madhe të Allahut. Sepse siç është komunikuar në Kur'an **“All-llahu dëshiron t’ju pranojë pendimin...”** (Nisa 27). Po edhe në një ajet tjetër Kur’anor Allahu faljen e tij e shpreh kështu:

Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten, pastaj kërkon falje të All-llahu, ai e gjen All-llahun falës dhe mëshirues. (Nisa, 110)

Allahu me faljen e tij të madhe njerëzve gjatë gjithë jetës së tyre u jep raste për tu penduar. Gjëja e vetme që duhet të bëjë njeriu është braktisja e mëkateve me kusht që mos të kthehet përsëri në të njëjtat mëkate dhe të pendohet sinqerisht duke e dëgjuar zërin e ndërgjegjes para se ti vi vdekja. Se për ndryshe Allahu nuk ia pranon pendimin:

Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t’i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: “Unë tash u pendova!” e as i atyre që vdesin duke

qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër. (Nisa, 18)

Të qenit e Allahut falës i mëkateve të njerëzve, të lënit e dënimit për më vonë, dhe dhënia e mundësisë për tu penduar në çdo çaste gjatë jetës është një shfaqje e mirësisë, mëshirës dhe dashurisë së madhe të Allahut për njerëzit. Sikur Allahu ti dënonte menjëherë njerëzit për shkak të mëkateve të tyre siç tregohet dhe në Kur'an nuk do të mbeste në tokë asnjë gjallesë. Allahu thotë:

Sikur All-llahu t'i dënonte njerëzit (zullumqarë) për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi të (tokë) asnjë gjallesë, por Ai i lë ata për më vonë deri në afatin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, për asnjë moment nuk mund ta vonojnë as ta ngutin. (Nahl, 61)

Prandaj, çfarëdo që të jenë mëkatet dhe gabimet e njerëzve të jenë, asnjëherë nuk është vonë për tu bërë një rob siç dëshiron Allahun. Sado që njeriu të ketë bërë mëkate dhe gabime çofshin të vogla apo të mëdha gjatë jetës së tij të ketë bërë, sado që te ketë jetuar larg obligimeve të fesë të ketë jetuar, në rast se pendohet sinqerisht dhe bëhet një njeri i devotshëm nuk ka nevojë të mendojë për mëkatet ose gabimet që i ka bë në të kaluarën. Sepse pasi të jetë penduar Allahu ia ka falë të kaluarën. Mëkatet ose gabimet që i ka bërë në të kaluarën mund ti mbesin vetëm si shembuj dhe këshilla mësimdhënëse që mos të kthehet përsëri në veprimin e tyre, po edhe për mos veprimin e atyre që janë të ngjashme me ato. Allahu se nuk do ti mbajë përgjegjës për të kaluarën robërit e sinqertë pasi e kanë gjetur rrugën e drejtë thotë kështu:

Thuaju atyre që nuk besuan, nëse heqin dorë (nga rruga e tyre e gabuar dhe besojnë) do t'u falet e kaluara, po nëse vazhdojnë, ligji (i Zotit), i zbatuar ndaj të parëve është i ditur (edhe juve do t'ju zë). (Enfal, 38)

Pa dyshim që kjo, është një lehtësi e madhe që e ka favorizuar Allahu për njerëzit në fe.

Allahu u përgjigjet lutjeve dhe çdo njeriut i është shumë afër

Bërja lutje Allahut në shoqëritë që jetojnë larg moralit të fesë është përzier me besimet e kota dhe besëtytnitë e ndryshme. Njerëzit edhe pse mund ti drejtohen Allahut me lutje në çdo çast, përsëri kanë caktuar ose kohë për lutje ose kanë vendosur ndërmjetësues. Allahu përballë këtyre besëtytnive dhe besimeve të kota njerëzve ua ka tërhequr vëmendjen kështu:

Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për All-llahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër All-llahut, s'ka dyshim se All-llahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë se All-llahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është rrenës, jobesimtar. (Zumer, 3)

Njerëzit i kanë devijuar nga rruga e drejtë ata persona që kanë thënë se ka nevojë për ndërmjetësime të ndryshme për ti bërë lutje Allahut. Mirëpo kur i shikojmë ajetet Kur'anore, vërejmë se për lutje nuk ka nevojë ndërmjetësim. Sepse edhe Allahu me ajetin Kur'anor **“Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij”** (Kaf, 16) tregon se më afër njeriut nuk është askush tjetër përveç Tij. Pra njeriu kur të dëshiron mund ti drejtohet me lutje Zotit, me lutje mundë të kërkon ndihmë dhe kështu Zoti ynë zërin e tij e dëgjon shumë mirë dhe i ndihmon në saje të lutjes që e bënë ai.

Prandaj për lutje nuk nevojitet kohë e caktuar apo e veçantë. Sepse Allahut mund ti bëhet lutje, në çdo kohë, në çdo çast dhe në çdo minutë. Në të kundërtën njeriu bëhet nxjerrës i rregullave nga vetvetja e vetë. Njeriu gjersa shkon prej një vendit në një vend tjetër, gjersa

zbret prej shkallëve, gjersa bënë shitblerje, gjersa përgatit ushqim, gjersa ngrenë ushqim, gjersa shikon televizion, gjersa është në lift (ashensor), gjersa pret në një vend, gjersa shkruan diçka, gjersa dëgjon radion, gjersa punon diçka, gjersa i veshë rrobat e veta, gjersa i veshë këpucët e veta, gjersa i lanë duart e veta, gjersa pastron diçka, gjersa përgatitet për të fjetur, kur zgjohet në mëngjes, kur bënë mëngjes, kur vozit makinën shkurtimisht në çdo vend dhe në çdo kohë të pa caktuar mund ti lutet Allahut ose ta kërkojë atë që dëshiron. Për këtë edhe është e mjaftueshme vetëm që ta kalon nëpër mend; sepse Allahu është i dijshtëm për çdo gjë dhe gjithmonë është më afër njeriut se damari që i rrah në qafë dhe në të njëjtën kohë është edhe i informuar dhe ka njohuri për të gjitha gjërat që njeriut i kalojnë nëpër mendje madje edhe për ato gjëra që njeriut i flenë në brendinë e zemrës.

Të gjithë ata që i luten Allahut. patjetër duhet ta dinë se Allahu është Përgjegjës i lutjeve të tyre. Me ajetin Kur'anor që do ta përmendim pak më vonë Allahu ka njoftuar se gjithmonë do tua lehtësoj punët në rast se i drejtohen Atij me lutje nevojtarët:

A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret, duke ia larguar të keqen e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos All-llahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni. (Neml, 62)

Pa dyshim kjo mundësi e Allahut që ua ka jep robërve të vetë shfaqë mëshirën e madhe të Zotit. Allahu me ajetet Kur'anore e komunikon afërsinë që e ka më robërit e vetë, miqësinë që e lidhë me ata që i drejtohen Atij dhe se i përgjigjet lutjes së lutësit:

E kur robit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua. (Bekare, 186)

Besimtarët duke menduarë dhe një herë mbi mëshirën dhe rahmetin e Zotit, duhet të jetojnë të përshtatshëm me mëshirën, lehtësi

dhe kënaqësinë e Allahut. Sepse kjo lehtësi që Allahu ua ka jep vetës së tyre është aç e madhe dhe e pakufishme saqë; Sunduesi i çdo gjëje, Poseduesi i vetëm i fuqisë superiore, u ka premtuar se do tu përgjigjet lutjeve të secilit njeri. Dhe padyshim Ai e mbanë premtimin e dhënë.

Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë

Sado që të shihen të vështira ngjarjet që përballohet njeriu gjatë jetës së tij të shihen prapë se prapë ato janë në nivelin e asaj që njeriu përball tyre mund të duroj dhe mundë ti përballoj. Ai që e ka krijuar njeriu dhe e ka pajisur me shpirt është Zoti. Dhe në këtë mënyrë Ai e di më së miri se sa mund të bartin njerëzit, pra sa mund durojë njerëzit përballë vështirësive. Kështu që Allahu askënd nuk e obligon përtej mundësisë. Në Kur'an thotë:

Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij... (Bekare, 286)

Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, e Ne as që obligojmë ndokënd çka nuk ka mundësi (të veprojë), të tillët janë banues të xhennetit dhe në të janë përgjithmonë. (A rafë, 42)

Pa dyshim ngjarjet që përballohen njerëzit ka mundësi të jenë të ndryshme. Andaj dhe durimi dhe mbështetja në Allahun përballë këtyre ngjarjeve tek njerëzit është e ndryshëm. Shumë njerëz sprovohen me ngjarje të ndryshme. Vetëm se Allahu për secilin njeri sprovat i ka bë në krahasim me forcën e tyre. Shembull: disa njerëz në këtë jetë vazhdojnë një jetë të varfër dhe me këtë jetë të varfër ata sprovohen se sa janë të durueshëm. Kurse disa tjerë jetojnë të pasur, po edhe këta në të njëjtën mënyrë sprovohen me atë se sa janë falënderues dhe tregues së moralit të bukur dhe shikohen se a janë të lidhur apo nuk janë të lidhur pas bukurive pas kënaqësive dhe dëfrimeve të kësaj jete. Por më në fund sikur ai që është i pasur, sikur ai që është i varfër për vetën e

tyre e jetojnë jetën më të mirë. Fukaraja sado që hekë prej varfërisë, kjo nuk është e papërballueshëm për atë. Në të njëjtën mënyrë edhe të pasurin, pasuria nuk e detyron të mburret, të bëhet mosmirënjohës dhe llostar. Në fund lidhja të cilën e kanë më Allahun këta njerëz, i bënë njerëz që i kryen obligimet e fesë, dhe që jetojnë moralin e Kur'anit. Këta njerëz në çdo situatë që përballohen, gjithmonë i drejtohen Allahut, vetëm prej Atij kërkojnë, dhe vetëm kënaqësinë e Zotit tonë e kërkojnë. Njerëzit e tillë asnjëherë nuk tregojnë dekurajim përballë vështirësive dhe nuk largohen nga feja sado e tmerrshme që të jetë situata me të cilën sprovohen. Për njerëzit e tillë që i besojnë dhe mbështeten Allahut, për ta treguar mëshirën dhe dashurinë e madhe Allahut atyre ua lehtëson edhe punën që shihet më e vështirë. Edhe në një ajet Kur'anor është treguar:

Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë (xhenneti) dhe atij nga ana Jonë do t'i bëjmë lehtësi (në jetë). (Kehf, 88)

Kurse në ajetet tjera këtë të vërtetë Allahu e ka lajmëruar kështu:

E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtë (Lejl, 57)

Ndërkaq ata që nuk i mbështeten dhe nuk i besojnë Allahut, u vinë të vështira edhe situata që janë më të lehta. Për këtë arsye Zoti këtyre njerëzve gjithmonë u jep vështirësi në jetë e kësaj bote, si shpërblim për atë që janë larguar prej moralit të Kur'anit, mosmirënjohjes së Allahut dhe mohimit të fes së vërtetë:

E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), dhe që përgënjeshton atë më të mirën, ne do ta përgatisim për më të vështirën. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të zhduket. Detyrë e jona është vetëm të udhëzojmë. (Lejl, 8-12)

Allahu bashkë me vështirësinë ka krijuar dhe lehtësinë

Gjersa Allahu njerëzit i sprovon në jetën e kësaj bote, me mëshirën e Tij të madhe ka jep myzhde që patjetër do të krijojn edhe lehtësinë bashkë me çdo vështirësi. Kjo myzhde në Kur'an tregohet kështu:

E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Înshirah, 5-6)

Në Kur'an kur të shikohet jeta e pejgambereve dhe jeta e besimtarëve të devotshëm, vërehet se Allahu ka krijuar një lehtësi pas gjendjeve të llojlojshme që janë parë sikur të vështirë kur janë përballuar ata. Allahu me cilësinë e tij "Fettah" tregon se është lehtësues dhe hapës i vështirësive të llojlojshme.

Në Kur'an jepet shembulli i besimtarëve që u shpërngulen nga vendi i tyre për hir të fesë dhe për shkakun e asaj që kishin mbetur nën ndikimin e dhunës dhe presioneve të ndryshme të jobesimtarëve u detyruan ti braktisin vendlindjet e tyre. Këta njerëz duke i lënë të gjitha punët, shtëpitë, kopshtet e bukura, pasurin, pronën, kishin mbetur të detyruar të emigronin për në vendet e panjohura dhe afër njerëz që nuk i kishin njohur kurrë më parë. Kjo gjendje kur të shikohet nga jashtë, vërehet se me të vërtetë është një gjendje e vështirë. Vetëm se Allahu në Suren En Nisa tregon që i begaton dhe që ua lehtëson gjendjen besimtarëve që shpërngulën dhe emigrojnë kështu:

Kush shpërngulet për hir (të fesë së) All-llahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. E kush del prej shtëpisë si migrues te All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe e zë vdekja (në rrugë), te All-llahu është shpërblimi i tij. All-llahu është mëshirues, mbulon të metat. (Nisa, 100)

Kështu që ky premtim i Allahut është treguar haptas mbi besimtarët që jetonin në periudhën e Pejgamberit a.s. Sahabet (shokët e Muhamedit a.s) që nuk u kanë dhënë rëndësi vlerave të dynjasë, meqë

i kanë marrë parasysh të gjitha vështirësitë duke treguar sakrificime të llojllojshme në rrugën e Allahut si shpërblim për këtë moral të bukur. Zoti ynë ata i ka mbrojtur dhe i ka begatuar në mënyrën më të mirë. Ua kishte lehtësuar secilën punë të tyre. Zoti në një ajet Kur'anor furnizimin, lehtësinë dhe përkrahjen që e kishin jetuar Sahabet (shokët e Muhamedit a.s) e komunikon kështu:

Përkujtoni kur ishit pakicë e dobët në tokë (Mekë) dhe frikësoheshit se do t'ju rrëmbejnë njerëzit (idhujtarët), e Ai ju mundësoi vend të sigurt (në Medinë) dhe ju përkrahu me ndihmën e Tij, ju furnizoi me të mira në mënyrë, që të jeni mirënjohës. (Enfal, 26)

Edhe në jetën e pejgambereve është evidentuar lehtësia që u ka siguruar Allahu atyre. Edhe ata kanë kaluar nëpër situata të ndryshme, por më në fundë kanë triumfuar përballë këtyre situatave.

Shembull: Në jetën e Jusufit a.s në shumë situata shihet lehtësia që ia kishte mundësuar Allahu prej mëshirës së Tij. Jusufi a.s pasi u hedhë në bunar nga ana e vëllezërve që ia kishin zili, ishte gjetur nga ana e një karvanit që kaloi afër bunarit. Personat që e nxorën nga bunari Jusufin a.s e shitën si rob tek një ministër. Pas një kohe, edhe pse Jusufi a.s nuk ishte fajtorë u burgos për arsye të disa shpifjeve që iu kishin bërë vetës së tij. Në shikim të parë gjërat që i ndodhen Jusufit a.s mund të shihen si gjëra të vështira. Por Allahu shpërblimin e mbështetjes dhe moralit të bukur që tregoj Jusufi a.s ia kishte dhënë në këtë botë dhe një të njëjtën kohë i kishte treguar që bashkë me vështirësinë e ka bërë dhe lehtësinë. Kështu që Jusufi a.s me dëshirën dhe lejen e Allahut pas një kohe të shkurtër doli nga burgu dhe u bë ministër i rëndësishëm i thesareve të shtetit. Ja pra, situata që u pa e vështirë u kthye në një situatë të rehatshme dhe të bukur.

Allahu edhe Musain a.s e kishte përkrahur me lehtësi përballë vështirësive që u përballua në jetën e tij. Musai a.s me përkrahjen dhe ndihmën e Allahut kishte fituar epërsi përballë Faraonit i cili ishte njëri

prej njerëzve më të pasur që kishte jetuar gjatë shekujve. Në të njëjtën kohë Zoti iu kishte përgjigjur edhe lutjes së Musait që bëri për t'ia dhënë si ndihmës të vetë të vëllanë Harunin a.s. Përsëri Musai a.s me përkrahjen dhe ndihmën e Allahut duke treguar murgjize (mrekulli) doli fitimtarë kundër magjistareve të Faraonit. Kështu që Musai a.s edhe në çastet më të vështira nuk e kishte harruar asnjëherë se ndihma e Allahut është gjithmonë me ata që kanë besuar. Musai a.s nga njëra anë gjersa u ndiqte nga forca ushtarake e Faraonit dhe nga ana tjetër që u përballua me detin, u kishte thënë atyre që i kishte afër se ndihma e Allahut gjithmonë është afër atyre që kanë besuar dhe në të njëjtën kohë ua kishte përkujtuar se gjithsesi Allahu do të tregoj një rrugë dalje:

Ai (Musai) tha: “Kurrsesi, me mua është Zoti im, Ai do të më udhëzojë”. Ndërsa Ne Musait i thamë: “Me shkopin tënd bjeri detit”. Deti u nda dhe çdo pjesë u bë si kodër e madhe. E Ne i afruam atje të tjerët (ata të faraonit). Dhe Ne e shpëtuam Musain dhe të gjithë ata që ishin me të. Kurse të tjerët i përmbytëm në ujë. (Shuara, 62-66)

Kurse një tjetër shembull nga jeta e Pejgambereve është të qenit afër Muhamedit a.s një besimtarë në çastin e fshehjes në një shpellë gjersa u ndjeknin nga ana e mushrikëve. Të qenit e një besimtarit përkrahës afër, në kohën kur kërcënimet e atyre që i bëjnë shirk Allahut kanë arritur nivelin e lartë është njëri prej lehtësive që ka caktuar Allahu:

Në mos e ndihmofshi atë (Pejgamberin), atë e ka ndihmuar All-llahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: “Mos u pikëllo (friko), All-llahu është me ne!” E All-llahu zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e All-llahut (është) më e larta. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti. (Tevbe, 40)

Me të vërtetë njeriu kur të shikon me syrin e mirësisë, do të mund t'i sheh në çdo çast lehtësitë që i ka krijuar Allahu për veten e tij. Vetëm se njerëzit që mund ta shikojnë këtë të vërtetë, janë njerëzit të cilët i besojnë Allahut, i frikësohen, ruhen dhe i mbështeten Allahut, duke e ditur se është kader (caktim i Zotit) çdo vështirësi që përballohen, dhe në të njëjtën kohë ata janë njerëz që e dinë se Allahu është mik dhe mbrojtësi i vërtetë i tyre. Allahu në ajetet Kur'anore, robërit e tillë i njofton që do tua lehtësoj punët atyre duke i begatuar prej nga nuk e shpresojnë aspak:

... Kështu këshillohet ai që i beson All-llahut dhe ditës së fundit, e kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij, All-llahu realizon dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin). (Talak, 2-3)

Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngushtë nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë All-llahu, e All-llahu nuk ngarkon askënd, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë All-llahu sjell çlirim (begati). (Talak, 7)

Siç kuptohet edhe në ajetet Kur'anore, Allahu patjetër ka krijuar lehtësi për ata persona të cilët lidhen me sinqeritet për urdhrat që i ka vendosur Ai. Besimtarët që i besojnë kësaj, asnjëherë nuk tregojnë ngathtësi, shtendosje dhe dobësim përballë vështirësive.

Allahu në Suren Īnshirah ka njoftuar se padyshim pas vështirësisë është lehtësimi, dhe se Ai vetë është hekës i barrës së rëndë të njerëzve:

A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd? Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde, E cila shtypte shpinën tënde. Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde? E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Īnshirah, 1-6)

Allahu besimtarëve në mënyra të ndryshme u siguron mbështetje dhe lehtësi të paparamenduar

Siç e kemi thënë edhe në fillim, kjo botë është krijuar si vend i sprovës. Të gjithë njerëzit në këtë vend sprovohen me besimin që e kanë për Allahun dhe ditë e ahiretit. Kur të shikohet nga jashtë një e vërtet e kësaj sprovës që e ka krijuar Allahu, vërehet sikur po jetojnë në kushte të njëjta ata që bëjnë mirë dhe ata që bëjnë keq. Megjithatë jeta që e jetojnë ata të cilët i kanë besuar Allahut është krejtësisht e ndryshme me jetën që e jetojnë ata të cilët nuk kanë besuar. Siç e kemi cek edhe në faqet e më hershme Allahu gjithmonë u jep lehtësi robërve që i besojnë Atij, ua lehtëson punët e tyre, gjithashtu edhe në çastet e vështira atyre patjetër ua tregon një rrugë dalje. Kjo, është një ndihmë e qartë e Allahut.

Po edhe Allahu në shumë ajete Kur'anore ka njoftuar që do t'ju ndihmojë me rrugë të paparamenduara robërve të vetë dhe në të njëjtën kohë atyre do t'ju sigurojë lehtësi dhe përkrahje në mënyrën që së shpresojnë. Këtë ndihmë që e ka njoftuar Allahu në Kur'an mund ta shtjellojmë nën këta tituj kryesor.

Allahu besimtarëve u dërgon ndihmë me engjëj

Allahu ndihmën që e ka për besimtarët e shfaqë në mënyra të ndryshme. Njëra prej ndihmave të Allahut, është dërgimi i engjëjve, kur besimtarët mbesin në çastet e vështira. Allahu e tregon këtë ndihmë duke dhënë si shembull ngjarjen e cila është përjetuar në kohën e Pejgamberit a.s.

Kur ti u thoshe besimtarëve: “A nuk është mjaft për ju që Zoti juaj t’ju vazhdojë ndihmën me tre mijë engjëjt e zbritur”? Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t’ju vinë tash

në këtë moment, Zoti juaj ua vazhdon juve ndihmën me pesë mijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar. E atë (ndihmë) All-llahu nuk e bëri për tjetër por vetëm për t'iu gëzuar dhe me të të qetësojë zemrat tuaja, përndryshe ndihma vjen vetëm prej All-llahut, ngadhënjyesit, të urtit. (Ali-Ëmran, 124-126)

Kurse në një ajet tjetër Kur'anor është treguar se Allahu besimtarëve u kishte ndihmuar me një ushtri që nuk ishte vërejtur nga ana e jobesimtarëve:

O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e All-llahu e shihte atë që ju vepronit. (Ahzabë, 9)

Të njoftuarit e Allahut në Kur'an që do të triumfojnë besimtarët gjithmonë është një premtimi i mirë dhe dashamirës për besimtarët. Vetëm se këtu ka dobi të sqarohet kjo pikë. Çdo ndihmë është prej Allahut, dhe padyshim që Allahu është posedues i forcës së pakufizuar. Besimtarët e dinë krejtësisht që Allahut i përket ndihma dhe fitorja e vërtetë. Kurse përkrahjen me engjëj, nuk e harrojnë që është vetëm një përgëzim (myzhde) i Allahut dhe se shfaqja e engjëjve është vetëm për ndihmën dhe përkrahjen e tyre. Sepse këtë Allahu në Kur'an e ka përkujtuar kështu:

Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai u është përgjigjur: “Unë do t’ju ndihmoj me një mijë engjëj që vijnë një pas një (grup pas grupi). All-llahu nuk e bëri atë (ndihmën) për tjetër, vetëm t’ju gëzojë (t’u japë myzhde) dhe për t’i forcuar (qetësuar) me të zemrat tuaja, pse ndihma në realitet është vetëm prej All-llahut. All-llahu është mbizotërues dhe i urtë. (Enfal, 9-10)

Besimtarët që e dinë se do të tu ndihmojë Allahu robërve që dëshiron në mënyra të ndryshme, jetojnë të qetë dhe në brendinë e tyre krijohet një ndjenjë e lumturisë, qetësisë dhe sigurisë. Në këtë mënyrë ata nga ana shpirtërore jetojnë një jetë shumë të bukur.

Allahu besimtarët në sytë e armikut i tregon të shumët

Si caktim i Zotit numri i atyre që kanë besuar, në çdo periudhë gjithmonë ka qenë i vogël. Vetëm se asnjëherë nuk kanë triumfuar përballë besimtarëve ata të cilët kanë qenë të shumët në numër. Besimtarët si me moral të bukur, si me largpamësinë dhe si me mendjen që ua ka dhënë Allahu gjithmonë kanë triumfuar sukses përballë njerëzve që gjendeshin brenda jobesimtarëve. Afër gjitha këtyre Allahu ka treguar se nganjëherë besimtarët në sytë e jobesimtarëve i ka treguar të shumët në numër dhe të fuqishëm dhe në saje të kësaj ka lindur frika, dobësimi dhe përfundimi i tmerrshëm i jobesimtarëve. Allahu një gjendje të tillë që është realizuar në kohë kur ka jetuar Pejgamberit a.s e komunikon kështu:

Përkujtoni kur u takuat (në sheshin e luftës), e Ai bëri që ata në sytë tuaj të duken pak, e po ashtu edhe ju të dukeni në sytë e tyre pak; e bëri këtë për ta zbatuar All-llahu një çështje që ishte e vendosur. Vetëm te All-llahu është përfundimi i çështjeve. O ju që besuat, kur të konfrontoheni me ndonjë grup, përqendrohuni dhe përmendni çdo herë All-llahun, që ta arrini fitoren e dëshiruar. (Enfal, 44-45)

Të shikuarit e numrit të vogël të besimtarëve si shoqëri e madhe, e fortë dhe e vështirë nga pikëpamja e jobesimtarëve pa dyshim që është një mrekulli e Allahut dhe në të njëjtën kohë edhe nga pikëpamja e muslimanëve është një lehtësi shumë e madhe që është përjetuar në çastet e luftës.

Përsëri Allahu me ajetet Kur'anore Pejgamberin a.s e ka njoftuar se besimtarëve do t'ju rritë forcën që e posedojnë kat kat. Dhe robërve që besuan si shpërblim për durimin që e bëjnë, u ka premtuar se do t'ju jep një fitore dhe një forcë më të madhe prej asaj që e shpresojnë:

O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë

njëzet të durueshëm, (trima të fuqishëm), do t'i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundni një mijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë (pse luftojnë). All-llahu ju bëri lehtësim tash duke e ditur se jeni dobësuar. Nëse prej jush janë njëqind të durueshëm, do ti mundni dy qind, e nëse prej jush janë një mijë, me ndihmën e Zotit do t'i mundni dy mijë. All-llahu është me ata që janë të durueshëm. (Enfal, 65-66)

Siç u njoftua në ajetin e më lartë përmendur Kur'anor, Allahu besimtarët në kohën e Pejgamberit a.s i ka përkrahur në çastin e luftës duke i treguar në sytë e jobesimtarëve të shumët në numër dhe shumë te fuqishëm. Nga kjo gjë kuptojmë se Allahu është miku dhe ndihmuesi i vetëm i besimtarëve. Sado që jobesimtarët të jenë të shumët në numër të jenë, sado që të posedojnë një forcë të madhe të posedojnë, prapë se prapë nuk do të mund të bëjnë asnjë gjë, sepse e gjithë forca dhe sundimi i takon Allahut. Prandaj Allahu është posedues i një forcës aq të madhe saqë me urdhrin “Bëhu” është në gjendje të bëjë çdo gjë. Andaj njerëzit që e vlerësojnë forcën e Allahut të mjaftueshme për çdo gjë, ata që i mbështeten dhe i besojnë Atij, gjithmonë do ta jetojnë lehtësinë e kësaj.

Allahu në zemrat e besimtarëve zbret ndjenjën e qetësisë dhe besueshmërisë

Përsëri në Suren Enfal njoftohet se Allahu i ka përkrah me ndihmë shpirtërore besimtarët në një çast të vështir që është përjetuar në kohën e Pejgamberit a.s kështu:

Dhe kur Ai ju kaploi me një kotje (gjumë) që ishte siguri për ju nga ana e Tij, ju lëshoi shi nga qielli për t'ju pastruar me të, largoi prej jush të shtimet e shejtanit, e që të fuqizojë bindjen në zemrat tuaja dhe t'ju përforcojë me të (me shi) këmbët tuaja. (Enfal, 11)

Pa dyshim që shprehja “kotje (gjumë)” që kalon në ajetin Kur'anor

ka për qëllim një gjumë shpirtëror. Kështu Allahu në çastin e vështirë e kishte dhënë një gjendje të tillë mbi besimtarët e sinqerisht dhe në fund të kësaj përkrahjes shpirtërore besimtarët e sinqertë e kishin jetuar lumturinë, qetësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e ndjenjave.

Në të vërtetë në jetën e besimtarëve gjithmonë do të jetë mbizotëruese ndjenja e forcës, lumturisë dhe qetësisë. Njerëzit që i besojnë Allahut dhe ahiretit, ngase e dinë se Allahu është mbizotërues i çdo gjëje, nuk acarohen përballë ndonjë situatë dhe nuk ndjejnë mërzë, brengosje, dhe shqetësim. Kështu ata e dinë që Zoti ynë për veten e tyre e ka krijuar më të mirën në këtë botë dhe në ahiret më të dobishmen. Andaj besimtarët e vazhdojnë jetën e tyre duke iu mbështetur Allahut dhe duke shpresuar në ndihmën e Tij. Në një ajet Kur'anor thuhet kështu:

Nëse All-llahu dëshiron t'ju ndihmojë, s'ka kush që mund t'ju mposhtë, e nëse Ai iu lë pa ndihmë, atëherë kush është ai pas Tij, që do t'ju ndihmojë? Pra vetëm All-llahut le t'i mbështeten besimtarët. (Ali-İmran, 160)

Besimtarët janë në dijeni të asaj se është kaluese sado e madhe të jetë vështirësia që përballohen në këtë botë. Prandaj ata përballë situatave të vështira, nuk tregojnë ndonjë sjellje që nuk e pëlqen Zoti.

Vështirësia në jetën e njeriut mund të zgjas eventualisht më së shumti 50-60 vite. Nëse njeriu brenda këtyre viteve tregon moral të bukur duke iu mbështetur Allahut dhe nëse e falënderon Atë për gjendjen në të cilën gjendet, në botën tjetër do të bashkohet me një bukuri aq të madhe saqë kurrë nuk e ka imagjinuar se do të ketë ndonjë bukuri të tillë. E kjo bukuri e madhe i përket xhennetit. Aty nuk do të ketë mërzitje, shqetësim, pikëllim, brengosje, halle, derte, përllarje, fyerje dhe në të njëjtën kohë ata aty do të kenë atë që e dëshiron dëshira e tyre.

Të qenit në dijeni të kësaj, të besimtari siguron qëndrueshmëri përballë çdo situatë dhe mbështetje të pa rrëzueshme dhe të palëkundshme. Kjo ndjenjë shpirtërore është njëra prej lehtësive më të mëdha në këtë botë.

Nuk duhet harruar që; të gjitha zemrat dhe e gjithë forca është në dorën e Allahut. Kështu që Zoti e krijon çastin që dëshiron, situatën që dëshiron dhe mënyrën që dëshiron. Përderisa Allahu nuk ja jep njeriut që kërkon qetësinë dhe sigurinë e ka të kotë arritjen e sajë në ndonjë rrugë tjetër. Të diturit e njeriut se çdo gjë është nën kontrollin e Allahut, është një lehtësi që e sjellë jetesa e Kur'anit. Andaj gjithmonë, prej rrugëve të ndryshme e gjen afër ndihmën dhe përkrahjen e Allahut njeriu që i drejtohet Atij për çdo punë dhe që pret vetëm nga Ai shpërblimin e çdo punës.

Sepse vetëm All-llahu është ndihmëtar i juaji dhe Ai është më i miri ndihmës. (Ali-Ëmran, 150)

LEHTËSIA E JETESËS SË MORALIT TË KUR'ANIT

All-llahu dëshiron t'ju lehtësoj (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paaftë (për t'u përballuar epsheve). (Nisa, 28)

Disa prej veçorive të bukura të domosdoshme të moralit të Kur'anit që Allahu i ka urdhëruar ato, janë si sakrifikimi, tolerimi, solidariteti, durimi, respekti, maturia, fisnikëria, besnikëria, bujaria, urtësia, drejtësia, falshmëria, ndershmëria, besueshmëria, fjala e bukur, mbajtja e fjalës, mbajtja e premtimit, të ushqyerit e fukarasë, të mbrojturit e jetimit, të ndihmuarit e nevojtarit, të kthyerit në kohë amanetin e marrë, mos grabitja e hakut (e drejtës) të dikujt, mos nënçmimi i tjerëve, dhe mos përqeshja e tjerëve.

Në të vërtetë të gjithë njerëzit me ndërgjegjen e tyre, e dinë shumë mirë se cili moral i bukur do ta kënaqë Allahun. Këtë moralin të bukur që e kënaqë Allahun e jetojnë vetë ata pësona që ia kanë frikë Atij. Si shembull të këtij moralit të bukur e kemi Pejgamberin a.s dhe As-habet (shokët) e tij. Si moralin e bukur të Pejgamberit a.s po ashtu edhe të As-habëve nuk e ka dëmtuar asnjë situatë.

Por që shejtani, shumicës së njerëzve jetesën e këtij moralit të bukur ua tregon të vështirë dhe të pamundshëm. Për këtë arsye morali i bukur i shoqërisë injorante është i hollë sikur peri i mëndafshit, që

këputet shumë lehtë. Shembull: një njeri që është shumë i matur dhe shumë zotëri, mund të tregojë mendjemadhësi, sjellje të pakëndshme, sjellje agresive, dhe sjellje sulmuese përballë disa gjërave të vogla që ia merr mendja se janë duke ia prishur qetësinë. Prandaj njerëzit që janë anëtar të shoqërisë injorante nuk dinë të bëjnë durim përball gjërave edhe më të vogla. Në shoqëritë e ditëve tona shumica e njerëzve janë duke e bartur kuptimin e këtij moralit të shtrembër. Ngase shumica i tregojnë njëri tjetrit sjellje të ngjashme, produktet e moralit të injorancës si; shtypja e tjerëve për mbrojtjen e të drejtave të veta, falsifikimi, egoizmi, lavdërimi, mashtrimi, gënjeshtria, hipokrizia, zilia, xhelozia, dyftysia, mburrja, tallja, përqeshja, mendjemadhësia, pamëshirshmëria, pandershmëria, pa turpëria, pa fytyrësia, arroganca, koprracia etj... shihen si veçori shumë normale të njerëzit që i përkasin moralit të injorancës. Madje edhe disa njerëz gjersa e prezantojnë vetën e tyre veçorit e këqija “unë jam koprrac, ziliqar, i pamëshirshëm ...” i njehin si pjesë të veçorive të mira dhe të rëndësishme. Si rrjedhojë e kësaj në përgjithësi një shumicë e madhe e njerëzve, e pranojnë veten e tyre me këto veçori negative.

Njerëzit që i përkasin këtij mendimit gjatë gjithë jetës së tyre nuk bëhen të lumtur. Sepse koprracia, zilia, pamëshirshmëria, hipokrizia, njerëzit gjithmonë i bënë agresiv. Ndërkaq siç e përcaktojmë edhe më herët Allahu fenë e ka krijuar të përshtatshme me natyrshmërinë e njeriut. Si rrjedhojë e kësaj në natyrshmërinë e njeriut ka ndjenjë të kënaqësisë nga zbatimet dhe nga shikimi i moralit të bukur. Kurse rrugët tjera janë të vështira dhe munduse të njeriut. Beduizam Said Nursiu njëri prej dijetarëve të rëndësishëm Islam në librin e tij Shualar (dritat) lehtësinë që sjellë jetesa e besimit dhe vështirësinë që sjellë kufri (mosbesimi) në jetën e njeriut e tregon kështu:

Rruga e besimit është e shkurtër, e drejtë, e përpiktë dhe shumë e shkurtër. Kurse rruga e kufrit (mosbesimit) është e gjatë, e vështirë,

dhe shumë e rrezikshme. Do më thënë në rrugë që të dërgon ka e lehta, e drejta, dhe ka e mira nuk ka shirk dhe mosbesim. Kështu që të vërtetat e besimit për njeriun janë të nevojshme sikur gjithësia për diellin. Kurse rruga më e rehatshme, më e shëndetshme, më e mirë, më e lumtur, më e shkurtër, më e rëndësishme në moralin njerëzor është në drejtim të siratit mustekim (rrugës më të drejtë). (Shuara, f. 490)

Përsëri ky dijetar në lidhje me këtë çështje thotë:

Të ecurit në rrugë e kufrit (mosbesimit) është më e rrezikshme dhe më e vështirë se të ecurit mbi akull. Kurse të ecurit në rrugë e besimit është e lehtë sikur me ecë në tokë, në dritë dhe me notuar në detë. (Mesnevi-i Nursiye, f. 71)

Një jetë pa besim njeriut ka mundësi t'ia përjetoj disa kënaqësi. Por këto kënaqësi që fitohen në këtë jetë pa besim janë të përkohshme dhe patjetër pas këtyre vjen mundimi dhe vuajtja. Njeriu sa do që jeton brenda, kënaqësive, bukurive, standardëve të mira nëse nuk ka besim, jeton shqetësimin e asaj që e dinë se një ditë do t'ia ikën nga dora të gjitha këto që i posedon. Kështu që të gjitha ato që i posedon do ti ikin nga dora ose me një situatë që do të përballohet në ditë e tij ose një ditë do të largohet nga këto bashkë me vdekjen e pashmangshme. Pra në një vend që nuk ka mbështetje, frikë, dhe besim në Allahun është krejtësisht e pamundur të jetohej një jetë e qetë, pa brenga dhe pa shqetësime.

Prandaj morali i bukur njeriut e shtynë gjithmonë kah qetësia, lumturia dhe dashuria e zjarrtë për të jetuar. Po edhe për njerëzit që e zgjedhin rrugën e besimit për ata ka një qetësi, kënaqësi të vazhdueshme në jetë e tyre që shtrihet drejt ahiretit. Po edhe nëse përpara u del ndonjë vështirësi, mangësi apo ndonjë gjë tjetër e padëshirueshme, e dinë që është e përkohshme dhe e jetojnë gëzimi e asaj që ua ka premtuar Allahu në jetë e ahiretit. Kurse është shumë e

lehtë ajo që duhet bërë për fitimin dhe bashkimin e dhuntive të përhershme: Nënshtrimi i urdhrave të Kur'anit dhe ndërgjegjes, me lejen e Allahut do ti bashkoj me bukuritë e përhershme të xhennetit.

Gjithmonë fitojnë ata që i nënshtrohen ndërgjegjes

Mendoni makinat që ecin në autoban... Të gjithë njerëzit që i ngasin këto makina në autoban u përkasin kulturave të ndryshme, profesioneve të ndryshme, moshave të ndryshme, personaliteteve të ndryshme, fizionomive të ndryshme shkurtimisht asnjë nuk i përngjan tjetrit.

Supozoni se dy makina nga gjitha makina tjera që gjenden në autoban kanë bërë ndeshje. Dhe njëri vozitës i makinës vërehet se është i lënduar dhe ka nevojë për ndihmë. Kështu njëri vozitës gjersa e kthen vetëm kokën e vetë, e shiko dhe përsëri vazhdo rrugë e vetë në autoban, tjetri vozitës e ndal makinën e vetë dhe duke i dalë në ndihmë vozitësit të plagosur, e dërgon në spitalin më të afërt dhe mundohet të bëjë për atë sa të mundet.

Dallimi më i rëndësishëm i këtyre dy personave është të dëgjuarit e njërit ndërgjegjen dhe mos dëgjuarit e tjetrit ndërgjegjen. Dallimi i kulturë, racës, arsimit, profesionit... në mes tyre nuk ka aspak rëndësi. Çdo njeri pa përjashtim, është posedues i zërit të ndërgjegjes që gjatë jetës gjithmonë ia thotë të drejtën. Gjersa bënë një veprim të gabuar, gjersa bënë mëkat dhe në çdo dyshim që bie patjetër ndërgjegjja atij ia thotë të drejtën. Kurse të përcaktuarit e zërit të ndërgjegjes është shumë lehtë. Sepse ndërgjegjja që ia thotë atë që është e drejtë njeriut përballë një ngjarjes, gjithmonë është zëri i parë që e ndjenë në brendësi. Në raste se njeriu i nënshtrohet këtij zërit të parë do të jeton një jetë të lumtur, të qetë dhe të rehatshme. Kurse në të kundërtën nëse i mbyllë veshët, nëse fillon të kërkon ndjesa dhe pretekste duke iu drejtuar epshit, do të mbet i detyruar të jetojë bashkë me dhimbjen shpirtërore të vështirësisë që nuk do të mund të shpëtoj lehtë nga kjo.

Për këtë arsye ekzistimi i ndërgjegjes është një dhunti dhe lehtësi shumë e madhe që njerëzve ua ka dhënë Allahu. Njeriu që e dinë vlerë e kësaj dhuntie dhe e përdorë ndërgjegjen, në çdo gjendje, bëhet zotërues i një kuptuarës e cila ia bënë të mundur ndarjen e të mirës prej së keqes, shpëtimin në këtë botë edhe në botën tjetër dhe në të njëjtën mënyrë ia siguron edhe kënaqësinë e Allahut.

Allahu ka njoftuar se ka shpëtuar ai i cili e patronë vetveten (ndërgjegjen).

Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten (ndërgjegjen) (Shems, 7-9).

Shprehja **“ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten”** në ajetin Kur’anor tregon çartë se e ka gjetur shpëtimin ai që i nënshtrohet ndërgjegjes.

Kurse gjendja e atyre që nuk u nënshtrohen urdhrave të ndërgjegjes në vazhdimin e ajeteve të lartë përmendura tregohet kështu:

E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten (ndërgjegjen) (Shems, 10)

Ndërgjegjja e një njeriut që nuk e jeton moralin që e pëlqen Allahu dhe që nuk e zbaton fenë, vazhdimisht atë vazhdon ta urdhëron kah e bukura, e mira dhe drejta, në fund të kësaj në brendi të njeriut bëhet një përplasje. Kështu që nuk ia lëshon jakën ditë as natë dënimi i bërjes së pa ndërgjegjes me qëllim. Kurse kjo ia shton torturën si në këtë botë po ashtu edhe në botën tjetër.

Lehtësia e nënshtueshmëris dhe Mbështetjes në Allahun

Secilit njeri në jetën e tij i ndodhin disa situata “të pakëndshme”, “të papërshtatshme”, dhe “të pa fat”. Këto situata që shihen gjatë jetës së njeriut ose mund të jenë situata të vogla që njeriu i përjeton në jetën ditore ose mund të jenë aç të mëdha sa që mund të ndikojnë negativisht

në mbarë jetën e njeriut. Njerëzit që nuk e jetojnë moralin e Kur'anit kur të përballohen me kësi lloj situatash të vogla apo të mëdha që nuk i pëlqen epshi i tyre, ndjejnë shqetësim, lodhje, brengosje, tendosje dhe frikë. Ndërkaq kjo e vërtetë është një torturë që ia përjetojnë vetvetes së tyre në fundin e asaj që jetojnë të pa informuar për një të vërtetë shumë të rëndësishme. Siç tregohet edhe në Kur'an Allahu nuk i torturon njerëzit por njerëzit e torturojnë vetë vetën e tyre. Nëse ata të cilët nuk kanë besuar ose edhe pse kanë besuar preferojnë një jetesë duke mos ua vënë vëmendjen të vërtetave që i ka komunikuar Allahu në Kur'an gjithmonë do të jetojnë brenda shqetësimeve, brengave, frikësimeve, mundimeve po edhe në të njëjtën kohë do të bëhen zotërues të shumë dobësive dhe dhimbjeve shpirtërore.

Kurse në jetën e dynjasë nuk do të ketë arsye që të jetojnë të brengosur, të shqetësuar, dhe të frikësuar ata njerëz që ua vejnë vëmendjen të vërtetave që i ka komunikuar Allahu në Kur'an. Sepse ata që kanë besuar, e dinë se çdo gjë që ndodhë është e shkruar (e regjistruar) në librin e quajtur "Levhi-i Mahfudh" dhe se sikur të gjithë njerëzit tjerë edhe vetë janë ndjekës të kaderit (caktimit të Zotit). Si rrjedhojë e kësaj ata nuk harrojnë asnjëherë se situatat që i ka krijuar Allahu çdo herë do të përfundojnë në të mirë për veten e tyre dhe se Allahu kaderin e robërve të devotshëm e ka krijuar në mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshëm për veten e tyre.

Një pjesë e njerëzve kaderin e dinë pak a shumë, mirëpo përsëri në lidhje me atë posedojnë një pretendim të gabuar. Për shembull në kaderin e njeriut mendojnë se është vetëm personaliteti i njeriut dhe fizionomia e tij (flokët, fytyra, gjatësia e shtatit, duarve...). Kurse çështjen e fitimit të parave, fitimit të profesionit, humbjen e pasurisë, ndodhjen e fatkeqësisë etj... nuk e mendojnë pjesë të kaderit. Dhe për këtë arsye mendojnë se do ta ndryshojnë atë. Shumë herë në mesin e rrethit tonë ku jetojmë i dëgjojmë njerëzit duke thënë: "ah sikur mos te

kishte bërë kështu nuk do ti ndodhte ajo”, “ah sikur mos të dilte në rrugë nuk do të bënte ndeshje etj...”. Këto janë fjalë që i thonë njerëzit që nuk e kanë shijuar ëmbëlsirën e besimit. Sepse në kaderin e njeriut është e caktuar e gjithë jeta, të gjitha situata që përjetohen gjatë gjithë jetës, çdo bisedë, çdo qastë, çdo shikim, çdo zë etj... Për shembull: Ju sido që të jetë leximin e këtij librit, të këtyre rreshtave në këtë qastë në këtë orë e keni pas në kader. Kurse Allahu këtë qastë, e ka ditur me miliarda vite, përpara se t’ju krijonte. Ndoshta ju derisa e keni lexuar këtë libër keni përjetuar shumë gjëra. Për shembull: Mu në kohën kur filloni ta lexoni këtë libër e dëgjoni se në derë po troket dikush. Kur e hapni derën e vëreni shokun tuaj. Në këtë mënyrë leximin e librit e keni lënë për më vonë. Kështu që trokitja e derës mu në kohën kur keni filluar të lexoni këtë libër, thënia e shokut tuaj fytyrë qeshur “mirëdita” pas hapjes së derës, lërja për më vonë leximin dhe të gjitha bisedat, fjalët, shakatë, qeshjet etj... që kanë kaluar gjersa keni qëndruar bashkë me shokun tuaj, ju ende pa i jetuar këto në dijeninë e Allahut kanë qenë të ditura para miliarda viteve. Allahu këtë temë e tregon kështu:

Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur’ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezantuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt. (Junus, 61)

Allahu është larg vendit dhe kohës. Kurse ai që i përket vendit dhe kohës është njeriu. Për këtë arsye e kaluara jonë, ky qastë dhe e ardhmja jonë te Allahu është një qastë që ka ndodhur dhe përfunduar. Për shembull: Dita tjetër e jetës tonë është një qastë e cila do të vi për neve. Kurse në të vërtetë aj qastë te Allahu ka ndodhur dhe përfunduar. Andaj Allahu tani është duke e ditur se çka do të vishni nesër, se çka do të shkruani nesër, se me këndë do të takoheni nesër, se çka do të bëni gjatë gjithë ditës së nesërme. Në të njëjtën mënyrë edhe tani është duke

e ditur se çka do të bëni pas një viti, pas dy viteve, pas pesë viteve, pas dhjetë viteve, pas tridhjetë viteve, pas pesëdhjetë viteve. Kështu që Allahu në këtë qastë është duke i ditur të gjitha ditët, detajet më të imëta madje edhe minutat dhe sekondat e të gjithë atyre njerëzve që kanë jetuar që nga Ademi a.s e deri më tani po edhe të gjithë atyre njerëzve që do të jetojnë që nga tani e tutje deri në ditën e kiametit. Allahu si kohen e gjatë si kohen e shkurtër e ka krijuar në një qastë.

Kurse është një lehtësi dhe dhunti e madhe për njeriun që e dinë se dija e Allahut është e pakufizuar dhe se është ndjekës i kaderit. Një besimtar i cili ka besuar me zemër të plotë dhe i është dorëzuar me sinqeritet Allahut, duke marrë mësim prej kaderit që është përgatitur për veten e tij, duke e përkujtuar me falënderim në çdo qastë, e ndjekë kaderin e tij me një rahat dhe siguri sikur një personi që e ndjekë një film ulur në fotele.

Një njeri i cili e bënë mikë dhe mbrojtës të vetës së tij Allahun, është i kënaqur prej çdo situatës që e ka krijuar miku dhe ndihmuesi i tij më i mirë. Në të njëjtën kohë ky njeri është i kënaqur edhe prej kaderit të tij. Allahu për ti sprovuar njerëzit, në kaderin e tyre mund të krijoj situata dhe pamje të llojllojshme. Vetëm se çdo situatë dhe pamje te Allahu është e fshehur dhe e planifikuar deri në hollësitë më të imëta dhe këto janë sipas nivelit të asaj që do të mund t'ju përballoj njeriu. Për shembull: Jusufi a.s edhe pse nuk ishte fajtor u burgos, në burg, aty kaloi disa vite. Pa dyshim që kjo ka qenë në kader të Jusufit a.s. Po Jusufi a.s ngase ju nënshtrua me gëzim dhe kënaqësi kaderit që e ka krijuar Zoti për veten e tij, burgu nuk ishte vështirësi, shqetësim, mundim, torturë, për në të kundërtën është parë si pamje dhe ngjarje që ia ka hapur derën e shumë dhuntive dhe shumë bukurive. S'ka dyshim që do të arrin ta kuptojë më shumë kënaqësinë e dhuntive një njeri që situatën e keqe apo pamjen e neveritshme e krahason me një ambiente shumë të mirë. Sepse edhe Jusufi a.s burgun pasi që e ka menduar si

ambient të mirë e ka jetuar më shumë kënaqësinë e dhuntive. Sigurisht që është shumë e ndryshme kënaqësia që do ta merr një njeriut që e sheh çdo ditë kopshtin me trëndafila, me kënaqësinë e atij që me vite të tëra nuk ka pa gjë tjetër përveç murit dhe betonit. Po edhe në të njëjtën mënyrë do të merr një kënaqësi më të madhe prej qetësisë dhe bukurisë një njeriu që e dinë se çka është vështirësia dhe e neveritshmja. Andaj në çdo gjë që Allahu e ka krijuar për njerëzit ka mirësi. Sepse siç ka njoftuar në Kur'an edhe Allahu pas çdo vështirësie vjen lehtësimi. Ndërsa ajo që u përket besimtarëve është nënshtrimi i kaderit dhe mos zemërimi i tyre përballë ndonjë situatës që shihet si e pakëndshme. Po ata duhet të jenë edhe të lumtur që bëhen pjesëtar të mundimeve kur përballohen me ndonjë situatë të padëshirueshme sepse Allahu në saje të durimit që bëjnë përballë asaj situatë do ti shpërblejë në botën tjetër.

Sigurisht besimtari që i nënshtrohet kaderit, në çdo çështje duhet të përpiqet të bëjë më tepër se ç' duhet bërë. Për shembull një person që është sëmur sigurisht që duhet të shkoj te mjeku, të kontrollohet, ti merr barnat, tu nënshtrohet rregullave që ia thotë mjeku dhe ti kushtojë kujdes çdo gjëje në lidhje me sëmundjen. Vetëm se ai e dinë se sëmurja, shkuarja te mjeku, trajtimi mjekësor i tij, marrja e barnave, nënshtrimi i fjalëve të mjekut ka qenë e shkruar në kaderin e tij. Për këtë arsye asnjëherë nuk shqetësohet, pikëllohet dhe brengoset. Dhe në këtë mënyrë ai e jeton lumturinë e saj që Allahu ka krijuar për te çdo të mirë. Të besuarit e një njeriut se në çdo situatë ka mirësi është shumë një çështje e rëndësishme.

Besimtarët e sinqertë i mbështeten Allahut dhe besojnë se për veten e tyre pas çdo situatës së vështirë ka lehtësi dhe mirësi. Kjo, është një veçori që vërehet vetëm te besimtarët. Pejgamberi ynë Muhamedi a.s këtë çështje e tregon kështu:

“Sa habitësh është gjendja e besimtarit. Sepse çdo punë e tij për atë është një mirësi. Kjo gjendje vërehet vetëm te besimtarët e jo te

ndokush tjetër. Kur i ndodhë një gjë që atë e bënë të lumtur, falënderon. Kurse kjo është mirësi për atë, kur i ndodhë ndonjë dëm duron, kurse edhe kjo për atë është mirësi” (Muslim, Zuhd 64, 2999).

Allahu është posedues i vetëm i forcës së pakufizuar dhe mbizotërues i vetëm i mbarë gjithësisë. Sido që të jetë për një njeriu që e dinë këtë të vërtetë nuk kërkon rrugë tjetër përveç rrugës së nënshtrimit dhe mbështetjes në Allahu. Sepse çdo situatë që përballohet, çdo bisedë, çdo zë çdo fjalë e njeriut është nën kontrollin e Allahut. Siç tregoj edhe Pejgamberi a.s çdo gjë që vjen prej Allahut për besimtarin është mirësi dhe bukuri. Allahu kuptuarën e mbështetjes së besimtarëve që janë në dijeni të kësaj e tregon kështu:

Unë iu kam mbështetur All-llahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim, vërtet Zoti im është i drejtë. (Hud, 56)

Ata të cilët nuk i mbështeten Allahut duke pretenduar se janë nën kontrollin dhe forcën e tyre çdo gjë, gjithmonë në shpirtin e tyre ka frikë shqetësim dhe pesimizëm. Kjo është e ngjashme emocionin, frikën, dhe dhimbjen që e ndjenë njeriu gjatë shikimit të një filmit. Edhe ani me emocionin, frikën dhe dhimbjen që e ndjenë mendon sikur do të mund ta ndryshon fundin e filmit. Prandaj sikur është e panevojshme dhe e pavend një frikë e tillë në të njëjtën mënyrë është edhe e panevojshme dhe e pavend mbërthimi në lakmi të ngjashme përballë atyre që përballohet një njeri që e ndjekë kaderin. Për shembull: janë krijesa të Allahut të gjithë ata persona që pasojnë padrejtësi nga njerëzit tjerë. Dhe Allahu i krijon këto situata vetëm për sprovimin e njeriut. Në rasë se besimtari u bënë durim këtyre situatave dhe shpreson fitimin e xhennetit, mëshirës dhe kënaqësisë së Allahut nuk bëhet asnjë arsye për hidhërimin dhe shqetësimin e tyre. Po edhe Allahu besimtarëve u dërgon ndihmë dhe u siguron lehtësi në çdo punë

të tyre. Ky është një premtim i prerë i Allahut. Allahu në një ajet Kur'anor për ata që kanë pësuarë shpifje thotë kështu:

Kjo është kështu! E kush ndëshkon tjetrin me të njëjtën masë me të cilën ka qenë i ndëshkuar vetë, e pastaj atij përsëri i bëhet e padrejtë, All-llahu do ta ndihmojë atë patjetër. All-llahu shlyen shumë të këqijat dhe falë mëkatet. (Haxh, 60)

Atëherë rruga e nënshtrimit dhe mbështetjes për besimtarët që e dinë miqësinë, ndihmën dhe forcën e Allahut është rruga e vetme, më e drejtë dhe më e lehtë për njerëzit. Nëse njeriu nuk e ndjekë këtë rrugë do të mbet nën barrën e asaj që nuk do të mund ta ngreh. Dijetari Islam Beduzzaman Said Nursiu në thënien e tij që do ta përmendim më vonë tregon se njeriu në raste se nuk i beson dhe nuk i mbështete Allahut gjithmonë do ta futë vetveten e tij brenda vështirësive. Ai thotë:

“Njeriu është i dobët, kurse fatkeqësitë e tij janë të shumta. Është i varfër kurse nevoja e tij është shumë e madhe. Është përgjegjës, kurse barra e jetës është bukur e rënd. Nëse nuk i beson Allahut dhe nëse nuk i mbështetet Allahut ndërgjegjja (vetë-vetja) e tij gjithmonë do ti mbet brenda vështirësive dhe dhimbjeve shpirtërore. Atë e lidhin të këqijat, vuajtjet, shqetësimet, brengat, mundimet. Ato ose e bëjnë si të pirë ose si përbindësh. (Sözler (fjalët), f. 29)

Këtu duhet të tregojmë që; ato që shprehen në thënien e dijetarit nuk janë thënie që shprehin ngushëllimin që duhet bërë njëri tjetrit në situata e vështira ose munduarën e shpëtimin të vetvetes prej vështirësive. Por këto janë krijimet e Allahut dhe pamjet e vërteta të jetës së kësaj bote.

Andaj gjersa e jetojnë shqetësimin dhe vuajtjen e mosbesimit dhe mosmbështetjes edhe në ditët më të lumtur njerëzit e injorancës, besimtarët i cili u beson të vërtetave, në çfarëdo kushte që të jetë e jeton gëzimi dhe qetësinë e lehtësisë së fesë.

Allahu xh.sh në Kur'an për besimtarët thotë kështu:

Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde në jetën e Dunjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim dhe xhennet). Premtimet e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukses i madh. (Junus, 62-64)

Do të jenë të shpëtuar ata që e ndjekin rrugën e kënaqësisë së Allahut

Nëse njerëzit i shikoni me vëmendje do ta vëreni se një pjesë e tyre gjatë gjithë jetës së tyre përpiqen ta fitojnë dashurinë, respektin dhe kënaqësinë e personave tjerë. Njerëzi e tillë mund ti vëreni në familjen tuaj, në mesin e shoqërisë tuaj, në mesin e vëllezërve apo motrave tuaja, në mesin e fëmijëve, në rrethin ku jetoni, në punë, në rrugë... Kjo, është një jetë e vështirë, lodhëse, shqetësuese dhe bërse në shumë pikëpamje. Para çdo gjëje, një njeri që e kërkon kënaqësinë e njerëzve tjerë, shumë herë do të mbet nën shtypjen e ndërgjegjes. Për shembull: një person vetëm për mos mu përjashtua prej grupit të shokëve që është njoftuar rishtazi me ata, turpërohet t'u tërheqë vëmendjen dhe t'ua thotë sjelljet që i sheh të gabuara te vetja e tyre. Ai vetëm nga frika se do të mbet i vetmuar dhe pa njerëz të rrethit, dëmtohet prej urdhrave të ndërgjegjeje. Kjo, në radhë të parë tek ai krijon një brengosje të madhe ndërgjegjësore dhe pas një kohe të shkurtër i shuhet krejtësisht ndërgjegjja dhe më në fund vjen në gjendjen që nuk do të mund ta ndanë të keqen me të mirën, të drejtë me të gabuarën, dhe të bukuren me të shëmtuarën.

Një vështirësi tjetër që e pretë një person që përpriqet ti bëjë të lumtur në një qastë disa njerëz, është mundësia e asaj që gjersa e bënë të kënaqur njërin mund ta hidhëron tjetrin. Një njeri gjersa e bënë të

kënaqur një shokë mund ta hidhëron familjen, po edhe mund ta humbë një shokë gjersa mundohet ta bënë familjen të kënaqur. Ose mund ta fitojë mos kënaqësinë e shokëve të punës një njeri që bënë çdo gjë vetëm për me hy ne sy te padronit. Kurse fundi i të gjitha këtyre, është i hapët se do të sjellje në jetën e një njeriut të tillë mos kënaqësi, mos lumturi, shqetësim, ngacmim, brengosje, mërzi dhe dhimbje shpirtërore.

Ndërsa besimtari e kërkon vetëm kënaqësinë e Allahut. Për atë nuk është me rëndësi ajo që thonë njerëzit e rrethit, po ajo që thotë Allahu është me rëndësi për atë. Pa dyshim që rruga më e drejtë është kërkimi i kënaqësisë së Allahut dhe veprimi sipas asaj që Allahu e ka cekur në Kur'an. Në Kur'an Allahu e tregon shembullin e atij që ishte ortak pa marrëveshje dhe të atij që është thjeshtë në posedimin e njeriut (që kërkimin e kënaqësisë).

All-llahu solli një shembull: Një njeri (rob) në posedimin e të cilit ishin ortakë pa marrëveshje mes vete dhe një njeri (rob) që është thjeshtë në posedimin e një njeriu. A janë ata të dy të një lloji (të një gjendjeje)? Lavdërimi i takon vetëm All-llahut, por ç'bën shumica e tyre nuk e dinë. (Zumer, 29)

Ashtu siç u njoftua në ajetin Kur'anor jeta e përshtatshme për njeriun është jeta e ndërtuar vetëm mbi kënaqësinë e Allahut. Dijetari İslam Beduzzaman Said Nursiu në thënien e tij që do ta përmendim pak më vonë ka thënë se do të sjellë një jetë shumë të lehtë çdo herë përpjekja për fitimin e kënaqësisë së Allahut. Ai thotë:

Në punët tuaja duhet të jetë kënaqësia e Zotit. Nëse ekziston ajo kënaqësi, nuk ka rëndësi edhe nëse prishet apo hidhërohet me ju e gjithë bota. Nëse Ai e pranon, s'ka ndikim te ju dhe nëse të gjithë njerëzit ju kundërshtojnë. Pasi Ai të pranon dhe të bëhet i kënaqur, edhe nëse nuk dëshironi ju Ai do ti bëjë popullin t'ju pëlqen. Edhe ata i bënë të pranoj. (Lem'allar, f. 154)

Kjo thënie e këtij dijetarit është shumë me rëndësi. Sepse njeriu vetëm atëherë kur e kërkon kënaqësinë e vërtet të Allahut mund të bëhet fetar i sinqertë. Nëse punën që e bënë e orienton për kënaqësinë e njerëzve atëherë brenda kësaj pune është përzier hipokrizia. Kurse një ndërtim i hipokrizisë, njeriun e futë në dëm si në këtë botë po ashtu edhe në botën tjetër. Veçanërisht, ata të cilët e kërkojnë kënaqësinë e njerëzve nuk mund ta shohin asnjëherë shpërblimin që e presin. Sado që të mundohet të hynë në syrin e personit që e ka përballë të mundohet, sado që të sjellët mirë me te të sillet përsëri nuk do të merr nga ai person vlerësimin e mirë. Edhe nëse e merr ai është një njeri i dobët. Kurse ai që përpiket ta fitojë kënaqësinë e Allahut do ta merr vlerësimin e Allahut në këtë botë po edhe në botën tjetër do të bashkohet me bukurit e mrekullueshme. Allahu në Kur'an ka treguar që do ta arrijnë shpëtimin ata që e ndjekin vetëm kënaqësinë e Tij kështu:

All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë. (Maide, 16)

Ndjekja e kënaqësisë së Allahut, njeriut do t'ia sjell në këtë botë dhe në botën tjetër një jetë me plotë kënaqësi, lumturi, gëzim dhe me shumë shumë lehtësi.

Sakrifikimi është i lehtë kurse egoizmi i vështirë

Në shoqëritë injorante njerëzit në përgjithësi dëshirat e tyre i mbajnë në planë të parë dhe çdoherë veprojnë me mendimin “në rend të parë për mua vjen qetësia ime, kënaqësia ime dhe komforti imë”. Kurse sakrifikimi, u vjen shumë vështirë epshit të këtyre njerëzve. Te këta njerëz sjelljet egoiste shikohen si vigjilente kurse sakrifikimi në përgjithësi komentohet si thjeshtësi dhe gjë e pavlerë. Ndërkaq sakrifikim për atë person që i kanë besuar Allahut është një fitim i

madh po ashtu është edhe një adhurim shumë i lehtë. Allahu kuptimin e sakrifikimit të besimtarëve e tregon kështu:

Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit të) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. (Ënسان, 8-11)

Besimtari që e mendon shpërblimin e përhershëm në ahiretit nuk i duket asgjë dhënia e pasurisë dhe ai gjithmonë vazhdon ta ndanë atë vetë për fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe për ta përjetuar ndjenjën që u përmendë në fund të ajetit të më lartë përmendur. Prandaj vlera e pasurisë që jepet në këtë botë përplot me mangësia është shumë më e pavlerë se bukuria dhe pasuria që ka përgatitur Allahu në xhennet. Besimtarët që i besojnë kësaj, sado i madh që të jetë sakrifikimi të jetë ata asnjëherë nuk presin nga njerëzit ndonjë lëvdatë apo ndonjë gjë tjetër.

Afër gjitha këtyre Allahu u ka premtuar bereqet dhe bollëk në këtë botë atyre që sakrifikojnë (huazojnë) për fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe në të njëjtën kohë atyre u ka premtuar se do tua jep edhe më tepës se ajo që kanë dhënë. Allahu këtë premtim në ajetet Kur'anore e komunikon kështu:

Kush është ai që i huazon All-llahut një hua të mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumëfish atë? All-llahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai. (Bekare, 245)

Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si i një kokrrë që i mbinë shtatë kallinj, në secilin kalli njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është bujar i madh, i di qëllimet. Ata që për hir të All-llahut e japin pasurinë e tyre, e pastaj atë që e dhanë nuk e

përcjellin me të përmendur e me mburrje, ata e kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre, për ata nuk ka frikë, ata as që do të brengosen. (Bekare, 261-262)

Siç u tregua në ajetin Kur'anor njeriu sa më shumë që shpenzon në rrogë të Allahut aç më shumë Allahu atë e furnizon me pasuri. Për këta persona që shpërndajnë (japin) në rrugë të Allahut nuk ka frikë aspak.

Kurse jobesimtarët pasi që nuk e dinë vlerën e sakrifikimit janë larg mëshirës, ndihmës dhe shpërblimit të Allahut. Ata janë shumë koprrac në pasuri. Edhe pse janë të pasur dhe kanë mjaftë të holla përsëri veten e tyre nuk e ndjenë të lumtur dhe të qetësuar. Sepse ata nga frika se mos po ju humbë pasuria ditë e natë bëjnë llogaritje dhe plane të ndryshme. Ama ata harrojnë se nëse dëshiron Allahu ua merr nga dora e tyre gjithë atë që e posedojnë. Andaj ata e dëmtojnë vetveten e tyre me moral të keq kurse mbesin të varfër prej bereqetit, qetësisë dhe lumturisë shpirtërore.

Falshmëria për njeriun është gjëja më e bukur dhe më e mire

Siç njoftohet edhe në ajetin Kur'anor: **“Ai është që pranon pendimin e robërve të vet dhe shlyen të këqijat dhe e di çka punoni.** (Shura, 25), Allahu është shumë falës. Edhe besimtarët si persona që i përshtaten moralit që e pëlqen Allahu, kur shohin ndonjë te keqe prej ndonjërit e falin dhe e zgjedhin largimin e të keqes me të mirë. Pa dyshim, durimi përballë të keqes, falja e një personit, mos tërbimi për hakmarrje, mundja e zemërimit është një veçori që u takon besimtarëve të sinqertë. Dhe shpërblimi i kësaj sjelljes është dashuria dhe kënaqësia e Allahut. Allahu në një ajet Kur'anor thotë kështu:

Të cilët japin kur janë shilir edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit. (Ali-İmran, 134)

Personi që falë dhe që mundohet ta kthen të keqen me të mirë bëhet përgatitës i një ambientit të mbushur me lumturi dhe me qetësi dhe në te njëjtën kohë bëhet personi më dashamirës në mesin e njerëzve. Edhe Pejgamberi a.s pasi që çdo herë e ka kthye të keqen me të mirë ka triumfuar gjithmonë. Siç dihet nga burimet e historisë Islame Muhamedi a.s kishte shkua në Taif për ti thirrur në besim njerëzit që gjendeshin aty. Populli i Taifit thirrjes së Muhamedit a.s iu përgjigjen me gurë. I hidhëruar nga kjo ngjarje pejgamberi a.s u ul të pushonte pakë. Në atë kohë i erdh Xhibrili a.s dhe i tha: O i dërguari Allahut! Unë jam nën urdhrin tënd. Nëse dëshiron i bashkoj ato dy kodrat dhe popullin e Taifit e zhduku menjëherë! I Dërguari a.s iu përgjigj: Jo? Sepse ky ende është një popull që se ka kuptuar ende të vërtetën, e kështu ndoshta një ditë do të dalin gjenerata që e falënderojnë Zotin. Ja pra pejgamberi a.s të keqes nuk iu hakmerr me të keqe.

Prandaj edhe ne duhet të jemi tolerues përballë të këqijave. Sepse nëse durojmë vetëm pakë do ta arrijmë atë që dëshirojmë. Gjithmonë duhet ta kthejmë të keqen me të mirë, sepse kur e bëjmë një gjë të tillë ndoshta do të heqim pakë ama do ta fitojmë personin që na kishte armiqësi dhe në të njëjtën kohë do ta arrijmë kënaqësinë, dashurinë dhe miqësinë e Allahut. Në një ajet Kur'anor tregohet kështu:

Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që kanë virtyt të lartë. (Fussilet, 34-35)

Allahu për shpërblim të moralit të bukur njerëzve u dhuron një jetë të lehtë dhe të bukur. Në rrethin e atij që nuk është falës gjithmonë ka armiq dhe urrejtje kurse në rrethin e atij që është falës gjithmonë ka miq dhe dashamirë që janë në gjendje ta flijojnë edhe veten e tyre për atë.

Modestia sjell një jetë të lehtë dhe të rehatshme

Mendjemadhësia dhe kryelartësia janë veçoritë e moralit të keq që krijojnë shqetësim dhe dëm të madh te njeriu. Kurse modestia, e kundërta, ajo njeriut i sjellë qetësi, kënaqësi dhe lumturi. Një njeri mendjemadh para çdo gjëje pretendon se të gjitha veçoritë e bukura i përkasin vetës së tij. Për shembull: Ai në vend që ta falënderojë Allahun për mendjen që ia ka dhënë, mburret dhe lavdërohet me atë. Kështu ai duke u lavdëruar me veçorinë e mendjes së vetë, gjithmonë njerëzit e rrethit të vetë mundohet t'i poshtëron dhe t'i shoh të vegjël. Dhe për atë që e bënë një gjë të tillë nuk duhet dhe nuk shihet i këndshëm në rrethin ku jeton. Ndoshta, njerëzit e rrethit mund ta donë, mund ta respektojnë, mund ta nderojnë, mund ta lavdërojnë, ama respekti, nderimi, dashuria dhe lavdërimi i njerëzve tjerë për këtë njeri nuk buron asnjëherë nga zemra, por buron nga frika dhe interesi. Dhe si rrjedhojë e kësaj njerëzit kryelartë, asnjëherë nuk kanë miq të sinqertë. Kështu që në rrethin e tij gjithmonë ka njerëz që shtihen kinse e donë.

Njëra prej dëmtimeve më të mëdha që ia bënë vetës së tij njeriu kryelartë, është mundimi i tij që të shihet nga njerëzit e rrethit si njeri i pa të meta dhe pa i mangësia. Për shembull siç thamë edhe në shembullin e më lartë përmendur një njeri kryelartë që lavdërohet me mendjen e tij gjithmonë pretendon se është më i ditur në mesin e njerëzve. Për këtë arsye ai gabimin kurrë nuk e pranon. Po edhe kur bënë ndonjë gabim mundohet që ta fsheh prej njerëzve tjerë, madje edhe është në gjendje të gënjejë vetëm që mos të vërehet gabimi i tij nga të tjerët. Ndërkaq njeriu është një krijesë shumë e dobët, posedon mangësia dhe është një krijesë që sprovohet në çdo çast të jetës së tij. Andaj janë shumë të natyrshme gabimet dhe mangësitë e njeriut. Kurse të munduarit e fshehjes së mangësive përpara njerëzve tjerë është shumë e panevojshme dhe e pakuptimtë.

Kurse një ndjenjë tjetër që gjende në epshin e njerëzve dhe që më

së shumti atyre ju përjeton brengosje është të sosorit (të gjendurit) e tyre më të dobishëm sipas të tjerëve për shkak të disa veçorive të tyre. Kjo, në të vërtetë është një veçori e shejtanit. Allahu kur e krijoi Ademin a.s, i kishte urdhëruar si në shenjë respekti engjëjt dhe shejtanët ti përulen Ademit a.s. Engjëjt, si krijesa që janë krijuar me moral të bukur menjëherë iu përulen Ademit a.s. Kurse shejtani, përuljen e kishte refuzuar dhe si ndjesë i kishte thënë këto fjalë:

Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i mirë prej tij, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijove nga balta!” (Sad, 76)

Siç u njoftua edhe në ajetin Kur’anor, shejtani për arsye se e kishte pa vetën e vetë më të lartë sipas krijesat tjera, e kishte tejkaluar aq shuma saqë e kundërshtoj edhe urdhrin e Allahut.

Kur’ani bënë fjalë edhe për ata të cilët kanë devijimin duke e pa veten e tyre më të lartë. Përshembull, Jahudit dhe krishterët kanë devijuar duke thënë **“Ne jemi bijtë e All-llahut dhe të dashurit e Tij”** (Maide, 18). Vetëm se dhe ata, po edhe të gjithë njerëzit, janë krijesa të dobëta dhe të mangëta që i ka krijuar Allahu. Andaj asnjë njeri nuk mund të thotë unë i fitova këto veçori dhe tani e tutje unë jam njeri i vlefshëm ne rrethin ku jetoj. Sepse vlefshmëria fitohet vetëm duke iu afruar Allahut dhe duke i kryer obligimet e fesë së lehtë, Islamit.

Përgjigja e Allahut që ua jep atyre që e pretendojnë veten e tyre më të lartë dhe më të privilegjuare në Kur’an është kështu:

“... E pse pra Ai ju dënon me mëkatet tuaja?” Jo, ju jeni njerëz që Ai ju krijoi. Ai i falë atij që do dhe e dënon atë që do. Sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithë ç’ka në mes tyre është vetëm i All-llahut dhe vetëm te Ai është e ardhmja. (Maide, 18)

Pretendimi i pa mangësisë dhe i pa gabueshmërisë, është një barrë shumë e rënd për njeriun. Mundohen të bëhen të privilegjuar në mesin e njerëzve, për këtë arsye mundohen ta mbajnë nën kontroll çdo çast, dhe çdo herë përpjekën të tregojnë një sjellje këmbëngulëse. Për shembull kur të marrin pjesë në ndonjë mbledhje dëshirojnë ta tregojnë

veten e tyre të mençur, të veshur mirë, të flasin bukur dhe të bëhen zgjedhës i çështjes. Bile edhe gjersa janë brenda ndonjë shoqëria, mundohen ta formojnë një mburrje, një dallim dhe një kulturë më të lartë dhe asnjëherë nuk pranojnë të përzihet me njerëzit që janë në dhomë apo me ndonjë kallaballëk tjetër. Kurse për këtë arsye janë sikur “mbi gjemba (thera)”. Asnjë lëvizje e tyre nuk bëhet nga brendësia e shpirtit dhe natyrshmëria. Çdo gjë që e bëjnë, bëhet me planë dhe llogaritje për të arritur pretendimi i tyre. Kurse kjo sa torturë e madhe do të jetë për një person dhe sa do të jetë ngarkimi i madh i barrës për njeriun është në shesh.

Mirëpo duhet të dihet se njerëzit të cilët janë mendjemëdhenj asnjëherë nuk do t'i arrijë ato gjëra që i synojnë. Sepse ata sa më shumë që bëhen mendjemëdhenj, aq më shumë e fitojnë dhe urrejtjen dhe zemërimi e njerëzve të rrethit të tyre, po edhe në të njëjtë mënyrë ata asnjëherë nuk do të mund t'i arrijnë qëllimet e veta. Allahu në një ajet Kur'anor mos arritjen e qëllimit të mendjemëdhenjëve e tregon kështu:

Ata që kundërshtojnë shpalljen e All-llahut pa pasur argument, nuk kanë tjetër në zemrat e tyre vetëm se një mendjemadhësi, me të cilën nuk do t'ia arrijnë qëllimit, e ti kërko mbrojtje te All-llahu, se Ai të gjitha i dëgjon dhe i sheh. (Gafir, 56)

Njerëzit mendjemëdhenj, sikur se nuk e arrijnë asnjë dëshirë në jetë e kësaj bote, ashtu nuk mund ta arrijë edhe dashurinë e Allahut. Allahu në një ajet Kur'anor këtë e tregon kështu:

Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. (Llukman, 18)

Kurse njerëzit e modestuar nuk e përjetojnë asnjëherë presonin dhe brengosjen që e përjetojnë njerëzit mendjemëdhenj. Sigurisht që çdo njeri dëshiron ta bënë më të mirën, më të bukuren dhe më të vlefshmen e çdo gjëje. Vetëm se janë brenda një humbjes së madhe ata të cilët i bëjnë këto për të hyrë në syrin e njerëzve dhe për tu ngopur me lakmitë

e dynjasë. Kurse një njeri modest, çdo gjë që bënë e bënë vetëm për ta fituar kënaqësinë, dashurin dhe mëshirën e Allahut. Kur të arrin diçka ose kur bëhet posedues i një gjëje të bukur, e dinë se këto nuk janë gjëra që i ka fituar vetë, por janë dhunti të Zotit që ia ka dhuruar vetës së tij. Po edhe kur e godet diçka e pakëndshme ose humbë diçka nuk e thotë atë që është në kundërshtim me atë që e ka urdhëruar Allahu. Kështu që ai e dinë se kjo situatë për veten e tij është një sprovë dhe në saje të kësaj i mbështetet Allahut për ta fituar më të mirën që rrjedh nga sprovat. Kështu që ai e jeton qetësinë e ëmbëlsirës së besimit duke mos u brengosur për gjërat e pa këdëshme që i ndodhin vetës së tij.

Dijetari İslam Beduizzamn Said Nursiu dallimin e njerëzve mendjemëdhenj dhe njerëzve modestar shkurtimisht e sqaron kështu:

Ai që e pëlqen vetveten e gjen belanë (fatkeqësinë), dhe bien në vështirësi. Kurse ai që nuk e pëlqen vetveten e gjen qetësinë, dhe shkon në mëshirë. (Mektubat, f. 301)

Këtë temë po e përfundojmë me një thënie të Muhammedit a.s ku thotë:

“Nuk do të hyjë në xhennet ai që ka në zemrën e tij mendjemadhësi, goftë dhe sa një grimcë e vegël e atomit”.

Qetësinë dhe lehtësinë që e sjellin sinjeriteti dhe drejtësia

Njerëzit e injorancës kur mbesin në gjendje të vështirë çdoherë e përdorin gënjeshtren. Sepse sipas tyre gënjeshttra është pjesë e ligjëratës që i nxjerrë prej situatës. Dhe për këtë arsye gënjeshtren e shohin si metodë shumë të lehtë për shpëtimin e vetës së tyre. Ndërkaq, gënjeshttra dhe mos drejtësia, janë prej drejttimeve më të këqija që posedon njeriu. Para çdo gjëje, një njeri që gënjen çdoherë e jeton acarimin e asaj që do të del në çdo çast gënjeshttra e tij në shesh dhe për këtë arsye frikësohet duke pandehur se do të nënvleftësohet prej të

tjerëve. Andaj gënjeshtër bëhet shkaktarë e frikshmit, brengosjes dhe nënvleftësimit të njeriut. Kurse në një ambientin që secili e gënjen njëri tjetrin ka hipokrizia dhe mos sinqeritet. Sepse çdo njëri dyshon te fjalët e tjetrit. Kështu që ata nuk i besojnë njëri tjetrit bile edhe për çështjet më të vogla. Prandaj është e qartë se nuk ka një miqësi të sinqertë aty ku mbretëron hipokrizia dhe mos sinqeriteti. Populli thotë: *“Aty ku ka sinqeritet, ka miqësi, dashuri dhe kuptueshmëri të vërtetë”*.

Ndërsa drejtësia për një njeri që i frikësohet Allahut është shumë e rëndësishme. Allahu në një ajet Kur’anor besimtarët i urdhëron kështu:

O ju besimtarë, pëmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thuani fjalë të drejta. (Ahzabë, 70)

Drejtësia dhe sinqeriteti, muslimanëve u sjell një moral shumë të bukur, një jetë me plot lumturi dhe siguri. Për shembull: një besimtarë asnjëherë nuk e fsheh prej të tjerëve gabimin që e bënë. Sepse e din se Allahu është duke e dëgjuar dhe shikuar në çdo çast dhe duke iu drejtuar Allahut pendohet për gabimin që e bënë. Nëse është e nevojshme që ta dinë edhe besimtarët tjerë, atyre ua tregojnë në mënyrën më të mirë dhe më të drejtë. Besimtarët e dinë që nuk do të mund ta përfitojnë sinqeritetin përballë një drejtësie të tillë. Andaj të jetuarit në mesin e besimtarëve të drejtë dhe të sinqertë është një dhunti e madhe e Allahut.

Kështu që duhet harruar se Allahu njerëzve të drejtë dhe njerëzve të sinqertë ua jep një ambient shumë të mirë, shumë të qetë, shumë të bukur, shumë të lumtur dhe shumë të sigurt në jetën e kësaj bote. Kurse ajo që do ta marrin në jetën e ahiret është shumë më e madhe dhe shumë më e bukur:

All-llahu tha: “Kjo është dita që të drejtëve u bën dobi drejtësia e tyre. Ata kanë xhennete në të cilët rrjedhin lumenj, janë për jetë të pasosur në to. All-llahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Ky është shpëtim i madh. (Maide, 119)

Morali i bukur i sjellë qetësi dhe qetësi jetës së çdo njeriut

Pa dyshim që morali i bukur sjellë qetësi dhe lehtësi në jetën e njeriut. Sepse në një shoqëri që mbizotëron morali i ulët, mbizotërojnë edhe gjërat e ndyta. E sigurisht që, ku ekzistojnë gjërat e ndyta nuk ka qetësi as trupi, e as shpirti. Pastaj edhe njerëzit me moral të ulët janë në gjendje të bëjnë çdo gjë që u kërkon eshpi i tyre. Për këtë arsye te këta njerëz nuk ka as siguri të shpirtit. Sepse ata në çdo çast janë në gjendje të plaçkitin, të vjedhin, të shajnë, të mashtrojnë, të tradhtojnë , të dhunojnë, të pinë alkool, të pinë drogë etj...

Kurse në shoqërinë e njerëzve të moralshëm ekzistojnë të kundërtat e këtyre veçorive . Aty mbretëron sinqeriteti, respekti, ndihma, solidariteti, toleranca, drejtësia, kuptueshmëria, dashamirësia etj ... Në këtë shoqëri njerëzit janë të sigurte si nga malli po ashtu edhe nga shpirti. Kështu që qetësia e trupit dhe shpirtit gjendet vetëm te njerëzit që posedojnë moral të bukur.

DINAKRIA E DOBËT E SHEJTANIT

Allahu çdo njeri në jetën e kësaj bote e sprovon me situata të ndryshme. Dhe çdo njeri sipas moralit dhe besimit që tregon në çastin e këtij sprovimit, e cakton jetën e tij të xhennetit dhe xhehennemit. Ndërsa kjo sprovë që Allahu e ka krijuar për njerëzit, është shumë e lehtë dhe e qetë. Siç u bisedua edhe në temat e mëhershme, ajo që i përket njeriu është jetesa e një jete që i sjellë lumturi dhe qetësi si në këtë botë po ashtu edhe në botën tjetër. Vetëm se njeriu këtë lumturi dhe qetësi mund ta arrin vetëm duke i zbatuar urdhrat, ligjet, preferimet dhe këshillat e Kur'anit. Mirëpo nuk duhet harruar se Allahu edhe shejtanin e ka krijuar brenda këtij sprovimit. Siç tregohet në ajetet Kur'anore shejtani është një forcë negative përballë besimit dhe në të njëjtën kohë ai me dinakërinë e tij mundohet ditë e natë t'i largon njerëzit prej rrugës së drejtë. Prandaj ai për ta bërë një gjë të tillë provon çdo rrugë, dhe njerëzve u kurdis kurthe të ndryshme. Allahu armiqësinë e shejtanit që e ka përball njeriut në një ajet Kur'anor e komunikon kështu:

O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët. (Bekare, 208)

Por, siç tregohet në ajetet Kur'anore dinakëria e shejtanit është e dobët dhe një njeri besimtarë e vëren menjëherë dinakërinë e tij dhe menjëherë mundohet ti shkatërron kurthet e tij. Allahu në Kur'an e ka njoftuar dinakërinë e dobët të shejtanit dhe mos detyrimin e tij ndaj njerëzve.

Ajeti Kur'anor i Sures Ibrahim mosdetyrimin e shejtanit e tregon kështu:

E pasi të kryhet çështja (të hyjnë ata të xhennetit dhe të xhennemit në të, xhennemlinjve) djalli (u mban ligjëratën e shëmtuar), dhe u thotë: “Vërtet, All-llahu ju pat premtuar premtim të vërtetë, e unë ju pata premtuar dhe, qe, nuk e zbatova premtimin ndaj jush. Po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’ju detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgjigjët; atëherë pra mos më qortoni mua, po qortojeni veten. Unë nuk mund t’ju shpëtoj juve, e as ju nuk mund të më shpëtoni mua. Unë mohoj shoqërimin tuaj që ma bëtë mua më parë (më adhuroat në vend të Zotit)”. S’ka dyshim, jobesimtarët kanë dënim të dhembshëm. (Ibrahim, 22)

Përsëri Allahu pushtetin e dobët të shejtanit në një ajet tjetër Kur'anor e njofton kështu:

Në të vërtetë, djalli realizoi mendimin e vet ndaj tyre, ndaj edhe e dëgjuan atë, përpos një grupi besimtarësh. E ai (djalli) nuk pati kurrfarë pushteti ndaj tyre, përveç që (dija e Jonë të dalë në shesh) të dihet ai që beson në botën tjetër, prej atij që është në dyshim për të. E Zoti yt është përcjellës ndaj çdo gjëje. Thuaj: “Thirrni ata, të cilët i menduat për zota pos All-llahut!” Ata nuk posedojnë sa një grimcë as në qiej e as në tokë dhe as që kanë në to ndonjë pjesë, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje. (Sebe, 20-22)

Andaj mos pushteti i shejtanit mbi njerëzit është një lehtësi e madhe që e ka caktuar Allahu për njerëzit. Shejtani njerëzve u

pëshpëritë për moralin e ulët, për të keqen, për mos besimin e Allahut dhe mos zbatimin e obligimeve fetare dhe në të njëjtën mënyrë ai mundohet që njeriun vazhdimisht ta dërgon në shirk. Vetëm se ai nuk zbaton presion për ti shti njerëzit me i bë këto gjëra, dhe kurthet që i kurdis kuptohen dhe janë të dobëta. Po edhe njeriu për të shpëtuar prej ndikimit të shejtanit nuk ka shumë nevojë të harxhon shumë mundim dhe shumë përpjekje. Sepse një njeri që mendon, e vëren menjëherë dinakërinë e shejtanit dhe në saje të kësaj nuk e zbaton atë që ia pëshpëritë shejtan. Për shembull shejtani njeriut jetën e përkohshme të kësaj bote mund t'ia tregojë dëfryese, tërheqëse dhe shumë të këndshme. Ai në të njëjtën mënyrë ka mundësi që edhe një djaloshit të ri t'ia ndejë jetën e kësaj bote sikur nuk do të mbaron kurrë, dhe në saje të kësaj mundohet që sa ma shumë ta lidh me atë. Ndërkaq, kjo përpjekje e shejtanit për një njeri që është i mençur, është e kotë, e dobët dhe pa ndikuese. Kështu që dinakërinë e shejtanit e prishë njeriu që e dinë se do të vdes një ditë, se të gjitha bukuritë e kësaj bote janë të përkohshme, se një ditë do të takohet me Allahun. Ose shejtani njeriut i pëshpëritë të bëhet kryelartë dhe pëlqyes i vetes së tij. Vetëm se për një njeri që e përkujton mangësitë, dobësitë dhe se një ditë do të ndahet nga kjo botë dhe pastaj do ti kalbet trupi në dhe do të shpëton lehtë prej kurtheve të shejtanit.

Sigurisht që kjo lehtësi, është për të sinqertit të cilët nuk dëshirojnë të jetojnë në ndikimin e të mallkuarit, po edhe në të njëjtën kohë është edhe për ata të cilët e synojnë, xhennetin, mëshirën, kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut.

Dinakëria e shejtanit mbi ata njerëz që nuk i frikësohet dhe strehohet Allahut do të jetë shumë ndikuese. Allahu në Kur'an ka njoftuar se nga shejtani do të jenë të mbrojtur vetëm ata të cilët janë të sinqertë:

Ai tha: “Pasha madhërinë Tënde, kam për t’i shmangur prej rrugës së drejtë që të gjithë, përveç atyre që janë të sinqertë nga robërit e Tu!” (Sad, 82-83)

Kurse në një ajet tjetër Kur’anor thënia e atyre që i përgjigjen shejtanit është kështu:

Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar. (Furkan, 29)

PËRFUNDIM

E dhe ju sikur të gjithë njerëzit tjerë që janë duke jetuar në sipërfaqen e tokës jeni duke iu afruar në çdo minutë dhe sekondë jetës së përhershme të ahiretit. Kjo është një e vërtetë e pa shmangshme... Një ditë në një mënyrë jeta e juaj do ta gjen fundin dhe pas kësaj ju do ta vazhdoni jetën në botën tjetër. Pas të vdisni do të dilni para Allahut dhe do të jepni llogari për të gjitha veprat dhe punët që i keni bërë në jetën e kësaj bote.

Andaj nëse e keni shikuar dhe ditur fenë si të vështirë tani e tuje mos vazhdoni ta bëni një gjë të tillë. Deri më tani ngase e keni pretenduar fenë si të vështirë, ka mund që të keni jetuar larg fesë, mund të mos e keni jetuar moralin e Kur'anit dhe mund të keni bërë disa gabime. Ama që nga tani e tutje me rëndësi është të pendohen sinqerisht te Allahu, të punoni atë që është më e mirë për ahiret dhe të orientoheni kah ajo që është më e lehtë. Kur ta synoni një gjë të tillë atëherë jeta e juaj do të merr kahja ka lumturia, kënaqësia dhe dashuria e zjarrtë për të jetuar.

Nocioni “një jetë e bukur” njerëzve u duket shumë i panjohur. Shumica e njerëzve jetesën e bukur e shohin larg jetës së tyre. Andaj shumica e njerëzve mendojnë se një jetë e qetë vetëm mund të imagjinohet. Ama një mendim e tillë u përket vetëm atyre personave që jetojnë larg fesë. Ndërsa mendimi për të jetuar jetën e lumtur dhe pa

brenga u përket atyre personave që i frikësohen Allahut dhe atyre që bëjnë punë të mira. Allahu këtë myzhde në Kur'an e njofton kështu:

Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Nahl, 97)

Siç u sqarua në pika të shkurtra gjatë gjithë librit, feja që Allahu e ka zgjedhur për njerëz është shumë e lehtë dhe e pamundimshme. Po në të njëjtën kohë edhe gjatë kapitujve të ndrysh u vërejt se kjo fe njeriu i sjellë qetësi, lumturi dhe kënaqësi ne jetën e kësaj bote. Ai njeri që e jeton këtë fe hyjnore gjithmonë do të jetë nën mbrojtjen e Allahut, në çdo punë do të ketë sukses dhe siç u tregua edhe në ajetet Kur'anore e jeton një jetë shumë të lumtur.

Atëherë edhe ju preferoni atë që është më e bukur dhe më e lehtë. Andaj duke e jetuar moralin e Kur'anit mund ta fitoni shumë lehtë një jetë të tillë. Sepse Kur'ani, është fjala e Atij që ka krijuar çdo gjë. Duke i lënë anash sugjerimet që i keni pa në televizion, që i keni dëgjua në radio, që i keni jetuar në shoqëritë ku jetoni deri më tani, orientoheni vetëm kah feja e lehtë dhe mendoni lehtësinë e jetesës së saj.

Mos harroni se nëse e lënë pas dore mundësinë e jetesës së asaj që është e lehtë mund të përballoheni me një dhimbje të tmerrshme që se keni shpresuar ndonjëherë. Andaj dijeni që jeta e kësaj bote do të mbaroj shpejtë. Dijeni që juve ju pret një jetë që kurrë nuk do të mbarojë. Prandaj që nga tani duhet të filloni të përgatiteni për atë jetë. Që nga tani e tutje mundohuni të bëni një jetë të frytshme duke i zbatuar urdhrat e Allahut. Sepse nëse i zbatoni urdhrat e Allahut, shpirti juaj do të shndritë si një yll para Krijuesit të tij. Shfrytëzoheni më punë të mira pjesën e vogël të jetës që u ka mbetur. Kalimi dhe sigurimi i një jetës së rehatshme dhe të bukur mos të jetë qëllimi juaj përfundimtarë. Mos mendoni se keni ardhur kotë në këtë botë, që secili të bëjë atë që

dëshiron, qoftë e mire apo e keqe. Punoni për ahiret sikur nesër do të vdisni. Punoni punë të mira gjersa jeni në ditët më të mira të jetës tuaj, sepse kur vjen pleqëria ankimet janë të kota, siç thotë dhe populli “Puno në rini që të kënaqësh në pleqëri”

Kini kujdes mos e humbni një gjë të madhe për një gjë të vogël. Lëreni të përkohshmen mendojeni të përhershmen. Mendojeni atë që e ka premtuar Allahu i madhëruar në Kur'an. Mos të na dukët kjo botë si një lule që kënaqemi duke e shijuar erën e saj. Keni kujdes nga kjo botë që është sikur helmi, e merr ai që nuk e njeh e mundohet ti afrohet sa më shumë, e padyshim që kur ti afrohet afër do të helmohet dhe të vdesë. Bëhuni të durueshëm, se nëse duroni vetëm pak do ta merreni të amshueshmen.

Më të vërtetë koha më të cilën jetoni është kundër të vërtetës. Po qese jeni më të vërtetën ndodh që të jeni ç'do herë të përjashtuar. Mos u merakosni, se gjithnjë do të kenë miq afër, e po që se nuk gjendet afër jush asnjë mikë, atëherë mos harro se Krijuesi i gjithësisë do të jetë miku më i mire i juaji. Padyshim që nëse jetoni më të vërtetën do ta kenë Krijuesin mikun më të mire të jetës tuaj. Pasi që Krijuesi të bëhet miku më i mire i juaji, jeta juaj do të marrë kahje ka lumturia, shpresa dhe dëshira e zjarrtë për të jetuar. Prandaj nëse ke besuar dhe je në rrugën e drejtë mos u frikëso nga askush. Sepse ata që besuan dhe ata që ecin në rrugën e drejtë duke bërë vepra të mira karakterizohen si krijesat më të mira dhe më të dobishme.

Hapni sytë dhe mendoni thellë, kthjellohuni dhe sa më pare filloni ta jetoni jetën e vërtetë që e preferon Kur'ani. Kështu që një ditë do të vdisni dhe do të kaloni në anën tjetër. Nuk mundesh të thuash “unë nuk dua të jetoj jetën pas varrit “. Prandaj të gjithë njerëzit që kanë jetuar në këtë sipërfaqe të tokës qoftë edhe një ore të vetme do të ringjallen për të jetuar në jetën e përhershme të ahiretit. Andaj mos vdisni duke qenë mëkatore, pa vepra të mira. Sepse kur të dilni para Allahut ankimi dhe

përgjërimi do të jetë i kotë. Si rrjedhim i kësaj, sa e sa njerëz në ditën kur do të dalin përpara Allahut do të kenë dëshirë për tu kthyer edhe një herë në këtë jetë, për ta kaluar tërë jetën në përkushtim, adhurim dhe mbështetje në Allahun. Kështu që fytyrat e këtyre njerëzve që do të përgjërohen do të jenë të nxira që i pret dënimi i rrebet i Allahut. Prandaj luteni Allahun që mos të jeni nga këto krijesa që e kanë merituar hidhërimin e Tij. Lutuni sa më shumë, sepse lutja e mbanë njeriun të lidhur në rrugën e drejtë ashtu siç e mbanë shtylla shtëpinë. Lutuni sa më shumë sepse zëri mi i ëmbël dhe më i bukur te Allahu është zëri i atij që lutet. Andaj lutuni Atij që t'ju pranoj lutjet, shpresoni tek Ai sepse ua plotëson dëshirat.

Përfundimisht, dini se kjo jetë është e shkurtër. Dini se kjo botë është si mashtues i afërt dhe i rrezikshëm që u afrohet atyre që i pëlqejnë ato që gjinden brenda saj. Dini se kjo botë është vrasës i të dashurve të vetë. Andaj ruajuni dhe bëhuni të kujdesshëm mos devijoni. Dini se bollëku i kësaj botë sjelle fatkeqësi dhe sprova të mëdha, ndërsa lidhshmëria më të medoemos të qon në dështim. Dini se i mençur është ai që e le kurse ai që e merr atë do të jetë i humbur. Dini se i mençur dhe i ditur është ai që i frikësohet asaj me çka e frikëson Allahu dhe ai që e ka llogaritur mirë që se shpejti do të ndahet nga kjo botë. Mos ija lejo vetës të jesh prej të humburve dhe prej atyre që kundër vetës tërhoqën hidhërimin e Allahut.

Mos harroni se: “Mëshira, kënaqësia, dhe dashuria e Allahut është vetëm mbi ata persona që sa më shumë e kujtojnë Atë”.

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darvinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të

shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Llojeve të Çarlls Darwin*. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darwinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegojë se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë forcë evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një

lečkë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: *“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”*¹

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.²

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.³

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁴

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?⁵

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁶

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallesh, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan

nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁸

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p. sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një

ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁹

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹⁰

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.¹¹

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.¹²

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darwinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.¹³

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët

i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionit. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë* pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”¹⁴

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.¹⁵

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.¹⁶

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.*¹⁷

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet

gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.¹⁸

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zharrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një

profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepira, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht.

E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruesit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara

nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar":

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.¹⁹

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët,

lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit:

Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua

ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në

mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrorjmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të

poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.²⁰

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

.....

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”***
(Sure Bekare: 32)

SHËNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neë York, p. 127.
8. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983. p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-13; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Ëalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ëith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
19. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Ëorld," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggerridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43